

DORACAK

PËR MËSIMDHËNËS ME AKTIVITETE
MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE



Shtator, 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Urdhëri i Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Komandëra në Detyrë/Office for Good Governance



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministaro Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



Save the Children



Sweden
Sverige

DORACAK

**Doracak për mësimdhënës
me aktivitete mbi
të drejtat e fëmijëve**

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës

Titulli:

Doracak për mësimdhënës me aktivitete mbi të drejtat e fëmijëve

Autore e doracakut:

Gresa Statovci

Redaktimi dhe lekturimi:

Berat Dakaj

Kapakët dhe faqosjen:

ASHA Graphics

Botuar nga:

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)

Projekti:

PROtectChild

Vëmendje!

Ky doracak është hartuar bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës në kuadër të projektit PROtectCHILD nga Advocacy Training and Resource Center (ATRC) në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Save the Children zyra në Kosovë dhe me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Aktivitetet janë përshtatur që të përkojnë me ligjin e lartpërmendur. Përgjegjësia për përmbajtjen e tij i përket zhvilluesit të saj. SIDA jodomosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Ky doracak është shqyrtuar dhe është bërë i vlefshëm nga MASHTI. I njëjti do të publikohet në uebfaqen e ministrisë për përdorim nga të gjithë mësimdhënësit.

PËRMBAJTJA

QËLLIMI I DORACAKUT	7
1. HYRJE	8
1.1. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës	8
1.2. Paraqitje e temave hyrëse	9

KAPITULLI 1 11

Udhëtim në planetin Mars.....	12
NEVOJAT DHE DËSHIRAT, katrorët.....	15
NEVOJAT DHE DËSHIRAT, pjesa 2	17
Unë kam të drejtë t'i shpreh ndjenjat e mia	18
EMOCIONET	20
Çfarë më duhet që të jetoj mirë?.....	21
Ta ndihmojmë ariun.....	22
Jetojmë bashkë dhe vetëm bashkë mundemi.....	23
DY GOMARËT	25
Gjërat që më pëlqejnë dhe s'më pëlqejnë.....	26
Unë kam zë që dëgjohet.....	27
Shtëpia dhe punët e shtëpisë.....	29
Pak relaks.....	30
Po, dua! Jo, nuk dua!.....	31

KAPITULLI 2 33

Të avokojmë për komunitetin tonë.....	35
PLANI I NDËRTIMIT	37
ROLET	38
Ndotja e mjedisit dhe të drejtat e fëmijëve	39
RASTET	41
Të mësohemi si t'i ndihmojmë shokët ose shoqet e abuzuara seksualisht.....	42
Çfarë të bëj?	44
Të krijojmë një shoqëri të barabartë jodiskriminuese	45
RASTET E DISKRIMINIMIT.....	47
Dhuna në internet	48

TIA.....	50
PERSPEKTIVA.....	51
Vajzë apo djalë.....	52
DJEMTË OSE VAJZAT.....	55
Shëndeti mendor.....	57
T'i kuptojmë shokët dhe shoqet me nevoja të veçanta.....	59
Unë dhe media.....	60
Ushqehu shëndetshëm.....	62

KAPITULLI 3

63

Kërkesë për komunë.....	65
Kërkesë për komunë - Ushtrim.....	68
Në këpucë të dikujt tjetër.....	69
SITUATAT.....	71
ROLET.....	72
Të mësohemi si t'i ndihmojmë shokët ose shoqet e abuzuara seksualisht.....	73
Të krijojmë një biznes të barabartë jodiskriminues.....	76
Vetëm sepse jam nga komuniteti rom, ashkali ose egjiptian.....	78
Shëndeti mendor.....	80
Ndikimi i mediave.....	82
SHENJA +18.....	84
KOMPANIA E PASTRIMIT: REKLAMË.....	85
KOMPANIA BIC: REKLAMË.....	86
KOMPANIA PËR QEPJE: REKLAMË.....	87
Mbrojtja nga substancat e dëmshme.....	88
Dhuna në internet.....	90
MIRA.....	92
ROLET.....	93
Feja dhe besimi.....	94
FESTAT ZYRTARE.....	95

KAPITULLI 4

96

Kuizi 1 - Klasat nga 1 deri 5 Përshkrimi.....	97
Kuizi 1 - Klasat nga 1 deri 5.....	100
Kuizi 2 - Klasat nga 6 deri 9 Përshkrimi.....	107
Kuizi 2 - Klasat nga 6 deri 9.....	110
Kuizi 3 - Klasat nga 10 deri 12 Përshkrimi.....	115
Kuizi 3 - Klasat nga 10 deri 12.....	118

QËLLIMI I DORACAKUT

Qëllimi i këtij doracaku është ta rrisë ndërgjegjësimin e mësimeve për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës të Republikës së Kosovës në mënyrë që mësimeve të të gjitha niveleve arsimore t'i vetëdijesojnë dhe edukojnë fëmijët për t'i realizuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre që u garantohen me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës të Republikës së Kosovës.

Për ta thjeshtësuar dhe lehtësuar kuptimin e të drejtave nga fëmijët, ky doracak përmban aktivitete të ndara për tri nivele:

Kapitulli 1 paraqet dhe përmbledh aktivitete nga klasa e parë deri në të pestën;

Kapitulli 2 paraqet dhe përmbledh aktivitete nga klasa e gjashtë deri në të nëntën; dhe

Kapitulli 3 paraqet dhe përmbledh aktivitete nga klasa e dhjetë deri në të dymbëdhjetën.

Përmbajtja e aktiviteteve të mëposhtme synim kryesor ka edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre, për të nxitur të menduarit kritik të tyre, që ta kuptojnë ndërlidhjen e të drejtave me realitetin praktik, ta njohin veten si fëmijë, shoqërinë dhe botën, të mësojnë ta shprehin opinionin dhe mendimin e tyre, t'i mirëkuptojnë dhe bashkëndiejnë me bashkëmoshatarët e tyre, të bëhen qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, ta ndihmojnë njëri-tjetrin, t'i mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e fëmijëve etj. Të gjitha këto njohuri që do të fitohen nga ky doracak do të shtjellohen nëpërmjet rasteve praktike të ndryshme, projekteve, paraqitjeve, lojërave, aktrimit dhe formave të tjera aktive.

Me fokus të veçantë në secilin aktivitet janë paraqitur të drejtat e fëmijëve, si: e drejta për jetesë të shëndetshme dhe të lumtur, e drejta për arsim, e drejta të mbrohen nga dhuna dhe abuzimi seksual, e drejta për zhvillim personal, e drejta për t'u argëtuar në kohë të lirë, e drejta për privatësi, e drejta për pjesëmarrje dhe qytetari aktive, e drejta për të shprehur opinione dhe mendime, e drejta për mbrojtje nga dhuna kibernetike, nga mosdiskriminimi dhe mbrojtja e këtyre të drejtave në jetën e përditshme.

1. HYRJE

Doracaku ka për qëllim arsimimin dhe ngritjen e vetëdijesimit të nxënësve rreth të drejtave për fëmijë nëpërmjet aktiviteteve të ndara sipas niveleve. Përveç aktiviteteve që kanë për qëllim shtjellimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës i Republikës së Kosovës, doracaku, gjithashtu, përmban aktivitete që janë në përputhshmëri të plotë me kompetencat kryesore të të nxënësve në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës:

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**
- **Kompetenca e të menduarit**
- **Kompetenca e të mësuarit**
- **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis**
- **Kompetenca personale**
- **Kompetenca qytetare¹**

Aktivitetet shtjellojnë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës nëpërmjet temave të ndryshme si: të drejtat themelore të fëmijëve, përgjegjësia institucionale për mbrojtjen e këtyre të drejtave, shëndeti mendor, mbrojtja nga të gjitha format e dhunës, mbrojtja në masmedia, shprehja e lirë e opinionit dhe mendimit, mbrojtja nga diskriminimi, mbrojtja e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, doracaku, përveç qasjes ndërkurrikulare, mund të përdoret për këto fusha kurrikulare:

- 1) Shoqëria dhe Mjedi;**
- 2) Jeta dhe Puna;**
- 3) Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti.**

1.1. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës qartëson të drejtat që i kanë fëmijët deri në moshën 18 vjeçe dhe obligimet e institucioneve për t'i mbrojtur këto të drejta. Ndër qëllimet kryesore të këtij ligji janë mbrojtja e fëmijës “nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, neglizhimi apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës”². Theks vihet tek ofrimi i një ambienti të sigurt dhe të lirë nga dhuna fizike, abuzimi seksual, mbrojtja në masmedia dhe mbrojtja

¹ MASHTI, Korniza e Kurrikulës e Arsimit ParaUniversitar e Republikës së Kosovës (e rishikuar), gusht 2016, Korniza Kurrikulare, organizimi, roli dhe funksioni, faqe 16, kontrolluar me dt.14.10.2021

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji nr. 06/L-084 , neni 1: Qëllimi, pika 1.2, kontrolluar me dt. 14.10.2021

nga çfarëdolloj diskriminimi. Ligji parasheh që fëmijët të jetojnë në një mjedis të shëndoshë dhe në një ambient të përshtatshëm për jetesë duke bërë “garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik”³. Gjithashtu, dhuna ndaj fëmijëve është e ndaluar me ligj në të gjitha ambientet, më konkretisht neni 38 thotë:

1. Ndëshkimi trupor dhe masat disiplinore, të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjelljet që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, janë të ndaluara në secilin ambient në shtëpi dhe familje, në institucionet edukativo-arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitetit.

Si pjesë kryesore për mësimdhënësit është detyra që e kanë institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe raportimin kur shohin shkelje të tyre. Ligji qartëson që duhet të ketë bashkëpunim në mes të institucioneve lokale dhe shtetërore dhe organizatave që merren me të drejtat e fëmijëve për t’u paraqitur dhe raportuar secili rast potencial i shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Në nivel lokal këto janë strukturat ku duhet të paraqiten shkeljet eventuale dhe raportimi i çfarëdolloj shkeljeje kërkohet me ligj:

- komuna; departamenti përkatës sipas fushës që mbulon lidhjet me të drejtat e fëmijës;
- qendra për punë sociale;
- policia.

Përveç të tjerash, institucionet arsimore i detyron ligji që të krijojnë kurrikula dhe aktivitete mësimore të përshtatshme për ngritjen e kapaciteteve të fëmijëve që përfshihen në ligj si dhe ngritje të njohurive të përgjithshme rreth të drejtave të fëmijëve.

1.2. Paraqitje e temave hyrëse

Doracaku përmban aktivitete me tema të ndryshme të cilat kanë për qëllim ta shtjellojnë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Këto tema ndërlidhen me nenet e ndryshme të përfshira brenda ligjit.

Kapitulli 1. Në këtë kapitull temat janë kryesisht rreth shtjellimit të emocioneve dhe ndjenjave të fëmijëve duke i mësuar që t’i shprehin ndjenjat dhe ta bëjnë dallimin në mes të nevojave dhe dëshirave. Fokus vihet edhe tek e drejta e fëmijëve për të pasur një jetë të shëndoshë, familje dhe shtëpi. Gjithashtu, përgjatë aktiviteteve nxënësit mësojnë se si mund ta shprehin opinionin e tyre dhe të drejtën e tyre për të thënë jo kurdo që nuk duan të bëjnë një gjë të caktuar.

Kapitulli 2 dhe 3. Në këta dy kapituj temat lidhen me aktivitetet e përditshme të fëmijëve.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji nr. 06/L-084 , neni 1 Qëllimi pika 1.5, kontrolluar me dt. 14.10.2021, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

Temat përfshijnë diskriminim gjinor, racor dhe ata fëmijë me nevoja të kufizuara; aktivitetet shtjellojnë format e diskriminimit që ndodhin në shoqëri. Gjithashtu, aktivitetet përfshijnë tema rreth të drejtës së fëmijëve për ta shprehur opinionin dhe metodat se si mund ta bëjnë atë. Fokus vihet edhe te format e dhunës kundrejt fëmijëve: (1) dhuna seksuale e cila shtjellon metodat si të ndihmohen fëmijët e abuzuar seksualisht; dhe (2) dhuna në internet e cila shtjellon format e dhunës nëpërmjet internetit dhe njëjtëson të ardhme të ndryshme të nxënësit. Temat e parandalimit të dhunës synojnë edukimin e fëmijëve për të promovuar sjellje të shëndosha, shmangur dhunën në secilin nivel: familje, shkollë dhe shoqëri, si dhe për ta rritur ndërgjegjësimin për raportim. Temë tjetër është shëndeti i fëmijëve duke u përqendruar në shëndetin mendor dhe shëndetin fizik nëpërmjet zgjedhjes së një stili të shëndetshëm të jetesës.

Kapitulli 3, shtesë. Si shtesë, kapitulli 3 shtjellon edhe tema rreth besimit fetar dhe ngritjes së tolerancës fetare. Gjithashtu, aktivitetet dhe temat e kapitullit 3 janë më të përqendruara në shtjellimin e ideve dhe aktiviteteve nga vetë nxënësit si, për shembull, zhvillimi i një biznesi jodiskriminues në të cilin nxënësit kuptojnë tërthorazi format e diskriminimit dhe metodat për t'i parandaluar ato, si dhe metodat për t'u mbrojtur nga substancat e dëmshme. Kapitulli 3 kërkon nga nxënësit të jenë proaktivë në kërkimin e të drejtave të tyre që u garantohen me ligj.



KAPITULLI 1

Klasat 1 – 5

Kapitulli 1 i këtij doracakut përmban aktivitete për nivelin klasor 1-5 të cilat lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e fëmijëve siç parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Marrë parasysh zhvillimin kognitiv të fëmijëve nga klasa 1 deri 5, aktivitetet janë dizajnuar me qëllim që fëmijët t'i kuptojnë të drejtat e tyre në formë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet lojës, vizatimit, diskutimit dhe tregimit. Aktivitetet janë të thjeshtësuara për këtë nivel dhe fokus të veçantë kanë zhvillimi emocional, kognitiv dhe praktik i fëmijëve duke i kuptuar të drejtat e tyre.

Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim shtjellimin dhe kuptimin e këtyre të drejtave të fëmijëve:

- **Të drejtat themelore** duke u bërë dallimi në mes të dëshirave dhe nevojave, dhe duke mësuar se çdo nevojë themelore për jetesë është e drejtë;
- **Pjesëmarrja aktive dhe qytetarizmi** duke e theksuar nevojën e bashkëjetesës në shoqëri;
- **Respektimi i pikëpamjes së fëmijës** duke qartësuar forma të ndryshme për marrjen e vendimeve dhe shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave;
- **Përgjegjësitë familjare** për ofrimin e të drejtave themelore për jetesë për fëmijët dhe kuptimin e këtyre përgjegjësisë;
- **Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës** duke u mësuar të thonë jo dhe t'i dallojnë ndjenjat që i lëndojnë;
- **Parimet e punës së fëmijës** duke theksuar përgjegjësinë për ta ndihmuar në punë të lehta familjen por, gjithashtu, të drejtën për ta refuzuar punën që nuk u pëlqen;
- **Loja dhe argëtimi** duke u ofruar mundësi për lojë dhe argëtim dhe duke theksuar të drejtën e tyre për pushim.

Gjithashtu, të gjitha aktivitetet në formë jo të drejtpërdrejtë përfshijnë edhe tema si diskriminimi, shëndeti, kultura, edukimi, pabarazia ekonomike dhe shoqërore.

Për ta lehtësuar punën e mësimitdhënësit, formati i të gjitha aktiviteteve është i njëjtë dhe përmban hollësi të thjeshtësuara për zhvillimin e secilit aktivitet. Përveç nivelit të njohurisë kognitive të nxënësve, po ashtu është marrë parasysh edhe qasja e mësimitdhënëseve në materiale për zhvillimin e aktivitetit dhe për secilin aktivitet ofrohen mundësi të cilat janë lehtë të zbatueshme. Nga mësimitdhënësi pritet që t'i modifikojë pyetjet dhe pjesët e aktivitetit në bazë të nivelit të njohurive të klasës.

Secili aktivitet përmban: (1) Titullin; (2) Qëllimin që tregon se cila e drejtë synohet të mësohet; (3) Nivelin; (4) Definicionet dhe Fjalët kyçe; (5) Materialet dhe opsionet shtesë; (6) Kohëzgjatjen; (7) Përshkrimi i aktivitetit - secili aktivitet është i përshkruar hollësisht me hapa përcjellës, pyetje për fëmijët dhe udhëzime të drejtpërdrejta; (8) Diskutim - pyetje shtesë për ta arritur qëllimin e aktivitetit; dhe (9) Koment - udhëzime për mësimitdhënësin se ku duhet ta vë theksin më shumë gjatë aktivitetit.

Titulli	Udhëtim në planetin Mars
Qëllimi	Të mësohen nxënësit të bëjnë dallimin në mes të gjërave të nevojshme dhe të dëshirueshme; të kuptojnë që nevojat elementare konsiderohen të drejta dhe të bëjnë ndërlidhjen mes tyre.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Definicionet dhe fjalët kyçe	Nevoja elementare: Nevoja për të jetuar, zhvilluar; siguria dhe pjesëmarrja në shoqëri. Të drejta: Të gjitha nevojat elementare që një njeri duhet t'i ketë. Gjëra të nevojshme: Çdo gjë që nevojitet për jetesë të mirë: uji, shtëpia, ushqimi. Gjëra të dëshirueshme: Diçka që dëshirojmë ta kemi por nuk është e nevojshme për jetesë: vetura, lojërat, telefoni.
Materialet	Shtypi i materialit “Nevojat dhe dëshirat” , faqe 15, 16 dhe 17, për secilin grup dhe prerja e tyre në 20 katrorë të veçantë. Opsionale: Në rast se nuk keni mundësi të shtypjes, atëherë shkruajini në tabelë të gjitha gjërat. Shih “Nevojat dhe dëshirat”, pjesa 2 dhe kërkon nga nxënësit t'i vizatojnë apo t'i shkruajnë në 20 katrorë të veçantë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Ndajini nxënësit në pesë ose gjashtë grupe. Shpërndajini te ta letrat e prera me “Nevojat dhe dëshirat” për secilin grup. Opsionale: Në rast se nuk mund t'i shtypni, kërkon nga nxënësit t'i shkruajnë apo vizatojnë gjërat e shkruara në tabelë - për klasën e parë, lexojini gjërat dhe kërkon nga nxënësit t'i vizatojnë. Mund të shkruani vetëm pesë ose gjashtë gjëra, por duhet të jenë nga grupi i nevojave dhe i dëshirave. 3 minuta
HAPI 2	Lexojeni këtë paragraf për të gjithë nxënësit në klasë: Ju jeni përzgjedhur për të shkuar dhe për të jetuar në planetin Mars. Aty do të vendoset një shoqëri e re dhe ju duhet t'i merrni me vete të gjitha gjërat që ju nevojiten dhe që i dëshironi për të jetuar dhe për t'u rritur. Janë gjithsej 16 gjëra të cilat janë caktuar për ju që mund t'i merrni me vete dhe ato janë të shkruara në katrorët që i keni përpara (ose të shkruara në tabelë). Ju mund të merrni edhe katër gjëra shtesë që mendoni se janë të rëndësishme dhe i vizatoni/shkruani ato në katër katrorët e zbrazët. Lexojini dhe shikojini të gjitha gjërat, pastaj vendosni se cilat prej katër gjërave shtesë dëshironi t'i shtoni. 10 minuta

HAPI 3	<i>Lexojeni këtë paragraf për të gjithë nxënësit në klasë:</i> Raketa me të cilën do të udhëtoni nuk ka shumë hapësirë dhe ju lejon të merrni me vete vetëm 14 gjëra e jo 20. Diskutoni në grup se cilat gjëra mund t'i merrni me vete. Vendosni një x në 6 gjërat që do t'i hiqni dhe t'i lini anash. 10 minuta
HAPI 4	<i>Lexojeni këtë paragraf për të gjithë nxënësit në klasë:</i> Më vjen keq t'ju njoftoj që raketa ende nuk ka hapësirë për 14 gjëra, por vetëm për 8 gjëra. Diskutoni në grup se cilat gjëra mund t'i merrni me vete që janë të domosdoshme për mbijetesë. Vendosni një X në 6 gjërat që do t'i hiqni dhe t'i lini anash. 10 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni për pyetjet e mëposhtme me të gjithë nxënësit e klasës:</i> • Cilat gjëra i keni hequr në raundin e parë? Pse? • A ishte raundi i dytë më i vështirë se i pari? Pse? • A kishit mosmarrëveshje në grup se cilat gjëra të përzgjidhen? Për cilat gjëra dhe pse? • Cili është dallimi në mes të gjërave të nevojshme dhe atyre të dëshirueshme? Cilat ishin nevojat e cilat dëshirat? • Cilat janë disa gjëra që ju nevojiten në jetë? Cilat janë disa gjëra që i dëshironi? • A dallojnë nevojat dhe dëshirat për njerëz të ndryshëm? Pse? 12 minuta
Koment	Mësimdhënësi duhet të bëjë të qartë që të gjitha gjërat e nevojshme për të mbijetuar, për t'u zhvilluar dhe për të qenë pjesë e shoqërisë janë të drejta të secilit. Të drejtat janë ato gjëra që është e nevojshme për secilin njeri t'i ketë. Të drejtat = nevojat për mbijetesë, për zhvillim dhe për të qenë pjesë e shoqërisë.

NEVOJAT DHE DËSHIRAT, katrorët



Shtëpi për jetesë



Ushqim të shëndetshëm



Mbrojtje nga abuzimi dhe neglizhenca



Edukimi



Shëndeti




Trajtim i barabartë dhe jodiskriminues



Ajër i pastër



Mundësi për t'u shprehur lirshëm




Kënd për lojëra dhe zbavitje



Ujë i pastër



***Mundësi për ta praktikuar kulturën,
gjuhën dhe besimin fetar***



Rrobat e stilit të fundit



Biçikletë



Udhëtime gjatë pushimeve



Dhomën tuaj personale



Kompjuter personal



Televizion



Telefon personal



Para sa të duash



Ushqim i shpejtë

NEVOJAT DHE DËSHIRAT, pjesa 2

NEVOJAT/TË DREJTAT (për mësimdhënësin)	DËSHIRAT (për mësimdhënësin)
• Shtëpi për jetesë • Ushqim të shëndetshëm • Mbrojtje nga abuzimi dhe neglizhenca • Edukim • Shëndet • Trajtim i barabartë dhe jodiskriminues • Ajër i pastër • Mundësi për t'u shprehur lirshëm • Kënd për lojëra dhe zbavitje • Ujë i pastër • Mundësi për ta praktikuar kulturën, gjuhën dhe besimin fetar	• Rrobat e stilit të fundit • Biçikletë • Udhëtime gjatë pushimeve • Dhomën tuaj personale • Kompjuter personal • Televizion • Telefon personal • Para sa të duash • Ushqim i shpejtë

Titulli	Unë kam të drejtë t'i shpreh ndjenjat e mia
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth të drejtës së tyre për shprehjen e ndjenjave dhe të drejtën të kenë ndjenja. Qëllim shtesë i këtij aktiviteti është që fëmijët t'i kuptojnë ndjenjat dhe që nuk janë të vetmit që i ndiejnë ato.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Materialet	Fleta, markerë ose lapsa për vizatim
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Vizatojini katër fytyra që shprehin emocione në tabelë. Shih 'Emocionet' në faqen 20. Kërkoni nga nxënësit që t'i vizatojnë katër fytyrat në një faqe secilën. Pyetini fëmijët çfarë ndjenja shpreh secila fytyrë, pastaj shkruani poshtë secilës fytyrë përkatëse: 'Gëzim', 'Zemërim', 'Frikë', 'Mërzi'. Sigurohuni që secili nxënës ka kuptuar se çfarë është secila ndjenjë. 10 minuta

	Lexojini situatat më poshtë dhe për secilën situatë kërkonti që secili nxënës të ngrehë lart një fletë me emocione varësisht se si ndihet për secilën situatë. Pas secilës situatë, pyetini nxënësit që dallojnë në përgjigje nga shumica se përse ndihen ashtu. Lexojeni këtë paragraf për nxënësit: Unë do të lexoj disa situata dhe ju më tregoni se si ndiheni në secilën situatë duke e ngrehur një fletë me emocione. Për shembull, nëse them që ‘Ju keni përfunduar testin e matematikës me sukses’ atëherë e ngrehni fytyrën e gëzuar ngaqë ky fakt ju gëzon, apo jo? Fillojmë tani. Si ndiheni nëse: 1. Nuk ju kanë lejuar të luani pa i përfunduar detyrat e shtëpisë. (Jepuni kohë që të gjithë të kenë mundësi të përgjigjen.) 2. Keni vrapuar më së shpejti gjatë orës së Edukatës Fizike. 3. Shoku ose shoqja juaj nuk luan më me ju. 4. Nuk i kuptoni detyrat e matematikës. 5. Mësuesi/ja do të mbajë orën e Edukatës Fizike çdo ditë. 6. Një anëtar i familjes nuk është mirë me shëndet. 7. Do ta hani ushqimin e pëlqyer për drekë. 8. Keni harruar detyrat e shtëpisë në shtëpi. 9. Një i panjohur ju përshëndet në rrugë. 10. Harrojnë të vijnë t’ju marrin nga shkolla dhe humbni rrugën për në shtëpi. 15 minuta
HAPI 3	Kërkonti nga nxënësit të tregojnë një situatë kur janë ndierë të gëzuar, zemëruar, frikësuar ose mërzitur. Pasi ta përfundojë njëri fjalinë, kërkonti nga nxënësit e tjerë që ndihen njëjtë si ai ta ngrehin dorën. Për shembull: ‘Unë jam i shqetësuar kur mësuesi/ja nuk ma jep fjalën kur e ngre dorën’. Secili nxënës duhet të shprehë një emocion. 20 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili nga ne kemi ndjenja për situata të ndryshme dhe kemi të drejtë t’i shprehim ato. Gjithashtu, e përmend faktin që nuk janë vetëm por që, siç e kanë parë tashmë, në klasë të gjithë ndihen pak a shumë njësoj në situata të njëjta.

EMOCIONET



GËZIM



MËRZI



FRIKË



ZEMËRIM





Titulli	Çfarë më duhet që të jetoj mirë?
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit se çfarë u nevojitet fëmijëve për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të lumtur dhe për t'u zhvilluar sa më shumë.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Definicionet dhe fjalët kyçe	Të drejtat themelore: Të drejtat që nevojiten për jetesë si: ushqimi, strehimi në shtëpi, siguria, shëndeti.
Materialet	Fleta dhe laps/ngjyra për vizatim
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Diskutoni me nxënësit se çfarë u nevojitet më së shumti që të kenë një jetë të mirë. Për t'i drejtuar te të drejtat themelore, pyetini:</i> 1. Çfarë ju nevojitet kur jeni të etur ose të uritur? 2. Si ndiheni kur jeni të uritur ose të etur? A mund të luani ose të mësoni? 3. Çfarë ju nevojitet kur jeni i/e sëmurë? 4. Si do të ndiheshit nëse nuk keni ilaçe për t'u shëruar? 5. A mendoni se ka fëmijë të varfër që nuk i kanë këto gjëra? Si ju bën kjo situatë të ndiheni? 10 minuta
HAPI 2	Kërkoni nga nxënësit ta vizatojnë veten në mes të një faqeje dhe t'i shtojnë përreth njerëzit e tyre të veçantë. Më tutje, të vizatojnë se çfarë u duhet për një jetesë të mirë. Kërkoni nga ta që të shkruajnë se çfarë janë ato gjëra. Ndihamojuni të shkruajnë nëse kanë nevojë. 20 minuta
HAPI 3	Pasi t'i kenë vizatuar gjërat që u nevojiten për jetesë, kërkoni nga disa prej tyre të paraqesin se çfarë kanë vizatuar. Pyetini të gjithë çfarë nëse nuk u ofrohen disa prej këtyre gjërave? 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë të kemi një jetesë të mirë dhe është përgjegjësi e shtetit të na ofrojë të drejtat themelore. Fokus duhet të vihet edhe në ngritjen e njohurive rreth fëmijëve të varfër të cilët mund të kenë mungesë të të drejtave themelore.

Titulli	Ta ndihmojmë ariun
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit se çfarë u nevojitet fëmijëve dhe cilat janë përgjegjësitë e të rriturve për t'u ofruar një jetesë të mirë.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Definicionet dhe fjalët kyçe	Të drejtat themelore: Të drejtat që nevojiten për jetesë si: ushqimi, strehimi në shtëpi, siguria, shëndeti.
Materialet	Një ari apo kukull
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Merreni me vete një vizatim të ariut, një lodër ari apo një kukull dhe lexojeni këtë tregim në klasë:</i> Ky është Skupi. Skupi është një fëmijë 6 vjeç dhe ka nevojë për ndihmën dhe kontributin tuaj që të mbijetojë dhe të ketë një jetesë të mirë. Skupi nuk ka asgjë të vetën personale dhe është në duart tuaja. Skupi është i lodhur, i uritur dhe pa shtëpi. Si do ta ndihmoni Skupin? Çfarë duhet të bëni për të? Ku do t'i gjeni gjërat që i nevojiten? 10 minuta
HAPI 2	Pasi ta keni lexuar tregimin, tregojuni nxënësve se do t'i ofrojnë Skupit çfarëdo që i nevojitet sapo të dalin jashtë. Zhvillojeni orën mësimore në një ambient të jashtëm - në oborrin e shkollës ose në një park të afërt. Kërkoni nga nxënësit të punojnë në grupe dhe të gjejnë zgjidhje si ta ndihmojnë Skupin. Ata mund të bëhen kreativë duke krijuar një strehë nga gjethet, të gjejnë ushqim diku në pemë dhe gjëra të tjera kreative. 20 minuta
HAPI 3	<i>Pasi ta kenë ndihmuar Skupin, pyetini nxënësit:</i> 1. Si u ndjetë kur e kuptuat që duhet të përkujdeseni për Skupin? A ishte vështirë? 2. Cilat ishin gjërat e para që Skupit i nevojiteshin? A vlen e njëjta gjë edhe për ju? 3. Çfarë mendoni, si ndihen prindërit ose kujdestarët tuaj që përkujdesen për ju? Çfarë bëjnë ata që t'ju ofrojnë kushte për një jetesë të mirë? 4. Si mund t'ua lehtësoni paksa punën prindërve ose kujdestarëve tuaj? 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë të kemi një jetesë të mirë por, gjithashtu, kemi edhe përgjegjësi. Theks duhet të vihet te puna që bëjnë prindërit, mësimdhënësit dhe kujdestarët për ofrimin e një jetese të mirë për fëmijët.

Titulli	Jetojmë bashkë dhe vetëm bashkë mundemi
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth bashkëjetesës së shëndoshë dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri. Të kuptojnë rreth lidhshmërisë ndërmjet njerëzve dhe shoqërisë, si ato bashkëfunksionojnë me njëra-tjetrën në një qytetërim aktiv.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Bashkëjetesa: Jetesa e shëndoshë e përbashkët me njerëzit në shoqëri. Qytetar aktiv: Pjesëmarrja në ndihmën për zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e gjërave të dëmshme për shoqërinë. Kompromisi: Arritja e një vendimi që është i pranueshëm për të gjithë duke bërë disa lëshime të gjithë.
Materialet	Shtypi i materialit “Dy gomarët”, në faqe 25, për secilin çift të nxënësve; gjashtë pjesët duhet të prehen në katrorë para se të fillojë aktiviteti. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund t'i vizatoni në tabelë me radhë të gjitha pjesët ose t'i paraqitni në projektor.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Ndajini nxënësit në çifte. Shpërndajuni letrat e prera me “Dy gomarët” për secilin çift. Opsionale: Në rast se nuk mund t'i shtypni, vizatojini në tabelë të gjashtë pjesët ose paraqitini në projektor me radhë. 3 minuta
HAPI 2	Në çifte, nxënësit i marrin gjashtë pjesët e “Dy gomarëve”. Ata duhet t'i renditin fotografitë nga e para në mënyrë që të mund të formulojnë një tregim në bazë të fotografive. 3 minuta
HAPI 3	Pasi ta formulojnë tregimin, bëhen dy çifte bashkë dhe e tregojnë versionin e tyre të tregimit. 10 minuta

HAPI 4	Kërkoni nga dy ose tri çifte vullnetarë të flasin për tregimin e tyre me të gjithë nxënësit e klasës. 7 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni për pyetjet e mëposhtme me të gjithë nxënësit e klasës:</i> • Cili ishte problemi i gomarëve në fillim? • Si u përballën me problemin në fillim? A funksionoi? Pse po ose pse jo? • Çfarë bënë për ta zgjidhur problemin? • A morën të dy gomarët çfarë dëshiruan? • A keni zgjidhur ndonjëherë ndonjë problem duke bashkëpunuar me dikë? 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që litari që i lidhë gomarët është simbol i bashkëjetesës në shoqëri dhe përderisa jetoni bashkë me të tjerët, gjithmonë është edhe litari. Nëpërmjet qytetërimit arrihet marrëveshja për një bashkëjetesë të shëndoshë dhe për një shoqëri aktive për zgjidhjen e problemeve. Secili fëmijë ka të drejtë të jetojë një jetë të shëndoshë shoqërore me trajtim të barabartë dhe pa konflikte.

DY GOMARËT



Titulli	Gjërat që më pëlqejnë dhe s'më pëlqejnë
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth të drejtës së tyre për shprehjen e opinioneve dhe mendimeve të tyre.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Materialet	Karriget në klasë në formë rrethore
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Ulini të gjithë nxënësit në rreth dhe diskutoni me ta për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë në klasë. Kërkoni nga secili nxënës të përgjigjet në këto pyetje:</i> 1. Cila është lënda e pëlqyer e tyre? 2. Cilat aktivitete në klasë u pëlqejnë më së shumti? 3. A ka diçka në klasë që nuk u pëlqen të bëjnë? Pse? Unë si mësues/e si mund ta bëj këtë gjë që t'u pëlqejë më shumë? 15 minuta
HAPI 2	Pasi të shprehën të gjithë për pëlqimet dhe mospëlqimet, filloni edhe një herë nga fillimi, por tani kërkoni që ata të zgjedhin një gjë që u pëlqen më së shumti dhe një gjë që nuk u pëlqen aspak, dhe kërkoni prej tyre të tregojnë pse. Pra, të përcjellin këtë format të fjalive: Më së shumti në klasë më pëlqen _____ sepse _____. Më së paku në klasë më pëlqen _____ sepse _____. 15 minuta
HAPI 3	Kërkoni nga secili nxënës të paraqesë në fletë se çfarë kanë thënë deri tash rreth aktiviteteve që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë nëpërmjet vizatimit, shkrimit apo ndonjë forme tjetër. Vizitoheni secilin që të shihni se çfarë kanë paraqitur. 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë t'i shpalosim pikëpamjet tona (në këtë rast çfarë na pëlqen e çfarë jo). Gjithashtu, i inkurajoni të mendojnë për veten si persona me të drejta dhe që kanë të drejtë ta shprehin mendimin dhe idetë e tyre.

Titulli	Unë kam zë që dëgjohet
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth të drejtës së tyre për shprehjen e opinioneve dhe mendimeve të tyre. Të kuptojnë që ata mund të ngrehin zërin në vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me ta dhe si ta ngrehin zërin. Të mësojnë rreth procesit të marrjes së vendimeve.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Definicionet dhe fjalët kyçe	Kompromisi: Arritja e një vendimi që është i pranueshëm për të gjithë duke bërë disa lëshime të gjithë.
Materialet	Karriget në klasë në formë rrethore
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Ulini të gjithë nxënësit në rreth dhe diskutoni:</i> • Kush i merr vendimet në familjen tuaj? Pse ata? • Çfarë vendime mund të merrni për veten në shtëpi dhe në shkollë? (Çfarë të vesh, ha, shfletoj në internet.) • Çfarë vendime keni marrë për veten prej se jeni zgjuar sot? • (Mësimdhënësi mund të marrë ndonjë shembull që e ka parë gjatë ditës të ndonjë nxënës.) • A ju dëgjojnë të rriturit kur thoni diçka për gjërat që ju ndikojnë? • Çfarë vendime do të kishit dëshirë të merrnit vetë? 15 minuta
HAPI 2	Shpjegojuni që tani po i vëni në krye të vendosin se si dëshirojnë të ndryshojnë një pjesë të klasës. Jepuni kohë të mendojnë rreth 5 minuta se çfarë dëshirojnë të ndryshojnë në klasë. Theksoni që zëri i secilit ka vlerë të njëjtë. Për t'ua lehtësuar mendimet, parashtrojuani këto pyetje: 1. Çfarë do ta bënte klasën më të mirë? 2. Çfarë do të zgjedhni nëse keni mundësi të ndryshoni? Pse? 15 minuta

HAPI 3	Nëse ka shumë sugjerime, pyetini nxënësit se si mund të arrijnë në një kompromis për përzgjedhjen e idesë më të mirë (ndoshta duke votuar!). Kërkojuni të japin ide se si mund të bëhet ndryshimi dhe shpalosni ndonjë vështirësi nëse ka. Bëni ndryshimin në klasë me votat më të shumta dhe kërkon nga nxënësit t’ju ndihmojnë. 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili nga ne kemi të drejtë t’i shpalosim pikëpamjet dhe idetë tona dhe kemi të drejtë të marrim pjesë në vendimet që merren rreth nesh. Gjithashtu, që me më shumë vendime dhe ndryshime vijnë edhe përgjegjësitë (kjo shpaloset kur kërkon nga ta t’ju ndihmojnë për arritjen e ndryshimit të kërkuar).

Titulli	Shtëpia dhe punët e shtëpisë
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit që secili ka të drejtë të ketë shtëpi/strehë dhe të theksohet rëndësia e të ndihmuarit njëri-tjetrit, por që askush nuk ka të drejtë të detyrojë një fëmijë të punojë për askënd.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Materialet	Fleta dhe lapsa/ngjyra për vizatim
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Kërkoni nga secili nxënës ta vizatojë planin e shtëpisë së tyre: dhomat e gjumit, banjën, dhomën e ndenjes, ballkonin dhe oborrin. Kërkoni nga ta ta identifikojnë funksionin e secilës dhomë. Sa janë duke vizatuar, jeni sensitiv rreth hapësirës që ata kanë për shkak të kushteve ekonomike. 15 minuta
HAPI 2	<i>Pasi ta kenë përfunduar vizatimin, diskutoni me ta:</i> 1. Çfarë duhet të bëhet që të mbahet shtëpia e pastër? 2. Kush merret me pastrimin e shtëpisë? Nëse thonë që vetëm nëna ose motra, pyetini se a është e drejtë që vetëm ato të përkujdesen për shtëpinë? 3. Çfarë mund të bëni ju që të ndihmoni për pastrimin e shtëpisë? 4. A përfundohen punët më shpejt nëse edhe ju ndihmoni në pastrim? (Diskutoni që ata nuk duhet gjithmonë të presin nga dikush që ta pastrojë dhomën dhe gjërat e tjera të shtëpisë.) 20 minuta
HAPI 3	Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë apo të vizatojnë se si do të ndihmojnë në pastrimin e shtëpisë. 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili nga ne kemi të drejtë të kemi një shtëpi por, gjithashtu, kemi përgjegjësi që të ndihmojmë në punët e shtëpisë.

Titulli	Pak relaks
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit që secili ka të drejtë të relaksohet dhe të pushojë.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Materialet	Telefon ose kompjuter për lëshimin e muzikës; muzikë të zhanreve të ndryshme: klasike, folklorike, pop, rock.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Në rreth, pyetini të gjithë nxënësit se:</i> • Si ndihen kur zgjohen nga gjumi? • Si ndihen në fund të ditës? Pse? • Çfarë bëjnë që të relaksohen? • Çfarë do të dëshironin të bënin që të relaksoheshin? 10 minuta
HAPI 2	Pasi ta kenë përfunduar diskutimin, tregojuni nxënësve se do të lëshoni muzikë të zhanreve të ndryshme dhe ftojini të gjithë të vallëzojnë si të dëshirojnë. Mund të vallëzojnë ngadalë, shpejt, në vend apo sido që të dëshirojnë. Filloni me muzikë të qetë klasike të ngadalshme për disa minuta, pastaj ndërrojeni muzikën në një zhanër më të shpejtë dhe vazhdoni ta ndryshoni ritmin. Në fund përfundojeni me një këngë që është shumë e shpejtë dhe inkurajojini fëmijët të kërcëjnë, të sillen e të vrapojnë derisa të lodhen. 20 minuta
HAPI 3	<i>Tani kërkoni prej tyre të ulen/shtrihen dhe të pushojnë me sy mbyllur. Lexojuni këtë paragraf:</i> Parafytyroni që jeni në vendin tuaj special ku pushoni (dhomën tuaj, në oborr të gjyshes, në plazh apo në mal). Parafytyroni që jeni duke pushuar dhe asgjë nuk mund t'ju pengojë. Pushoni për ca kohë duke menduar për vendin tuaj special. <i>Pas disa minutave kërkoni që të gjithë të zgjohen dhe pyetini:</i> 1. Çfarë ju pëlqeu më së shumti? 2. Si u ndjetë kur e menduat vendin tuaj special? 3. Si do të ndiheshit nëse nuk mund të pushoni kur jeni i lodhur? 25 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë të relaksohemi, të pushojmë dhe të argëtohemi.

Titulli	Po, dua! Jo, nuk dua!
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit që është në rregull të thonë 'po' ose 'jo' dhe është e drejtë e tyre të refuzojnë kërkesa të paarsyeshme.
Niveli	Klasa 1, 2, 3, 4, 5
Materialet	Një palë çorapë
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Në rreth diskutoni për gjërat që i themi po ose jo. Për shembull, po për ushqim të shëndetshëm dhe jo për të shkuar diku me dikë të panjohur. Pyetini nxënësit se në çfarë raste kanë thënë po ose jo. 15 minuta
HAPI 2	Pasi ta kenë përfunduar diskutimin, kërkon nga nxënësit të ngrehen në këmbë dhe ia jepni njërit prej tyre çorapët. Kërkon prej tyre t'i gjuajnë çorapët te një nxënës tjetër. Para se ta gjuajë njëri, e thërrisni në emër nxënësin që dëshiron ta gjuajë dhe shikoni se si po reagon. Tregojuni nxënësve që nëse dëshirojnë të gjuajnë me çorapë t'i zgjatin duart për ta pritur, ndërsa nëse nuk dëshirojnë t'i bëjnë duart kryq. 10 minuta

HAPI 3	<i>Pasi të përfundojë loja, diskutoni se përse disa nxënës kanë thënë po e disa jo?</i> 1. Çfarë ju shtyu të mos prisni çorapët? 2. A u ndjetë në presion për t'i zgjatur duart për t'i pritur çorapët? Ndërlidhini përgjigjet e tyre me ndjenjat e tyre. A kanë thënë jo ngaqë nuk janë ndierë qetë ose të frikësuar që do të lëndohen, apo se nuk mund të pritnin? Shpjegojuni që nëse themi po ose jo, ne i përzgjedhim gjërat që nuk na pëlqejnë ose na pëlqejnë. <i>Pastaj pyetini:</i> 1. Çfarë mund t'jua cenojë sigurinë tuaj? Kur ndiheni i/e pasigurt dhe në rrezik? 2. A ju ka ndodhur ndonjëherë mos të ndiheni rehat me diçka, por prapë të thoni po? 3. Kur thoni zakonisht jo për diçka, kur ndiheni rehat apo kur nuk ndiheni mirë dhe të rrezikuar? 20 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë të themi po ose jo varësisht se si ndihemi. Në rast se nuk ndihemi qetë, është në rregull plotësisht të themi jo. Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë të sigurt dhe të mos i lëndojë askush.



KAPITULLI 2

Klasat 6-9

Kapitulli 2 i këtij doracaku përmban aktivitete për nivelin klasor 6-9 të cilat lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e fëmijëve siç parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Marrë parasysh zhvillimin kognitiv të fëmijëve nga klasa 6 deri 9, aktivitetet janë dizajnuar me qëllim që fëmijët t'i kuptojnë të drejtat e tyre në formë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet diskutimeve, roleve, rasteve dhe punimeve konkrete. Aktivitetet fokus të veçantë kanë zhvillimin emocional, kognitiv dhe praktik të fëmijëve duke i kuptuar të drejtat e tyre.

Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim shtjellimin dhe kuptimin e këtyre të drejtave themelore të fëmijëve:

- **Të drejtat themelore**, si e drejta për strehë, për ushqim dhe për ambient të pastër të jetesës;
- **Pjesëmarrja aktive dhe qytetarizmi** duke theksuar nevojën e bashkëjetesës në shoqëri dhe shprehjen e mendimit të lirë;
- **Respektimi i pikëpamjes së fëmijës** duke qartësuar forma të ndryshme për marrjen e vendimeve dhe shprehjen e mendimeve dhe të ndjenjave;
- **Mbrojtja nga diskriminimi** duke vënë theks të veçantë te fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komunitetet pakicë, gjinia dhe gjendja shoqërore-ekonomike;
- **Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës** duke përfshirë dhunën në internet dhe abuzimin seksual;
- **Mbrojtja nga masmedia** duke qartësuar ndikimin e mediave në jetën e përditshme me qëllim mënjanimin e ndikimit;
- **Loja/argëtimi dhe shëndeti** mendor duke u ofruar mundësi për lojë dhe argëtim dhe duke theksuar të drejtën e tyre për pushim.

Për ta lehtësuar punën e mësimitdhënësit, formati i të gjitha aktiviteteve është i njëjtë dhe përmban hollësi të thjeshtësuara për zhvillimin e secilit aktivitet. Përveç nivelit të njohurisë kognitive të nxënësve, po ashtu është marrë parasysh edhe qasja e mësimitdhënëse në materiale për zhvillimin e aktivitetit dhe për secilin aktivitet ofrohen opsione të cilat janë lehtë të zbatueshme. Nga mësimitdhënësi pritët që t'i modifikojë pyetjet dhe pjesët e aktivitetit në bazë të nivelit të njohurive të klasës.

Secili aktivitet përmban: (1) Titullin; (2) Qëllimin që tregon se cila e drejtë synohet të mësohet; (3) Nivelin; (4) Definicionet dhe Fjalët kyçe; (5) Materialet dhe opsionet shtesë; (6) Kohëzgjatjen; (7) Përshkrimin e aktivitetit - secili aktivitet është i punuar me hapa përcjellës, pyetje për fëmijët, dhe udhëzime të drejtpërdrejta; (8) Diskutim - pyetje shtesë për ta arritur qëllimin e aktivitetit dhe (9) Koment - udhëzime për mësimitdhënësin se ku duhet ta vë theksin më shumë gjatë aktivitetit.

Titulli	Të avokojmë për komunitetin tonë
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe qytetarizmit. Të kuptojnë rreth lidhshmërisë ndërmjet njerëzve dhe shoqërisë, si ato bashkëfunksionojnë me njëra-tjetrën në një qytetërim aktiv. Të mësohen të shprehin mendimin e tyre dhe të drejtën e tyre që të kenë opinion.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Avokim: Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shoqërisë nëpërmjet rekomandimeve publike. Bashkëjetesa: Jetesa e shëndoshë e përbashkët me njerëzit në shoqëri. Pjesëmarrje aktive: Pjesëmarrja në avokimin për zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e gjërave të dëmshme për shoqërinë. Kompromisi: Arritja e një vendimi që është i pranueshëm për të gjithë. Opinion: Pikëpamje dhe mendim rreth një çështjeje të caktuar.
Materialet	Shtypi i materialit (1) “Plani i ndërtimit” në faqen 37 dhe (2) “Rolet” në faqen 38. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund ta vizatoni në tabelë ‘Planin e ndërtimit’ ose ta paraqitni në projektor, ndërsa ‘Rolet’ i shkruani në fleta të vogla dhe ua shpërndani.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Ndajini nxënësit në grupe. Shpërndajuni ‘Planin e ndërtimit’ dhe letrat e prera me ‘Rolet’ për secilin grup. Opsionale: Në rast se nuk mund t’i shtypni, vizatoheni në tabelë ‘Planin e ndërtimit’ dhe lexojuni me zë përshkrimin. ‘Rolet’ i shkruani në fleta të vogla me përshkrim të shkurtër. 3 minuta
HAPI 2	Në grupe, pasi ta lexojnë përshkrimin dhe rolin e tyre, nxënësit i shkruajnë të gjitha të mirat dhe problemet që ndërlidhen me planin e ri të ndërtimit. Ata patjetër duhet t’i shkruajnë të mirat dhe problemet nga pikëpamja e rolit që u është dhënë. Grupet pastaj duhet të vendosin nëse janë për ose kundër planit të ndërtimit. Nëse janë kundër planit, ata duhet t’i tregojnë arsyet. Nëse janë për planin, duhet të tregojnë saktësisht se si do të zbatohet plani duke i hequr problemet që mund të shkaktohen. 15 minuta


HAPI 3	Pasi të përfundojnë, të gjitha grupet paraqesin pikat e tyre dhe pozicionin e tyre kundrejt planit të ndërtimit. Nëse janë kundër planit, ata duhet t'i tregojnë arsyet. Nëse janë për planin, duhet të tregojnë saktësisht se si do të zbatohet plani duke i hequr problemet që mund të shkaktohen. 20 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni me ta për pyetjet e mëposhtme:</i> • A ka ndonjë grup/rol tjetër që nuk është përfshirë në diskutim? • Cili grup duhet të ketë më shumë peshë në këtë vendim? • Si është ndërruar mendimi juaj kur i dëgjuat grupet e tjera? • A mendoni që gjatë një vendimi të tillë nga komuna merren parasysh të gjitha mendimet e secilit grup? 7 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që vendime të tilla merren nga komuna përkatëse vazhdimisht. Gjithashtu, mësimdhënësi duhet të shpjegojë që Ligji për të Drejtën e Fëmijëve kërkon që fëmijët të kenë kënde lojërash dhe mjedise sportive, si dhe të drejtën për shprehjen e opinionit të tyre të lirë.

PLANI I NDËRTIMIT

Komuna është duke punuar të bëjë një ndërtim të ri në lagjen “Toka”. Deri më tani kjo lagje ka 500 banorë dhe është një lagje e varfër në të cilën punojnë shumë pak njerëz. Ka shumë pak vende pune në këtë lagje. Ata që janë të punësuar udhëtojnë çdo ditë në qendër të qytetit.

Lagjja “Toka” ka disa shitore ushqimore, një shitore për veshmbathje, një farmaci, një shkollë, një qendër të mjekësisë familjare dhe një park të vogël te lumi. Banesat në këtë lagje janë të gjitha trekatëshe dhe të vjetra. Qytetarët thonë se banesat kanë nevojë për renovim.

Projekti i ri i komunës do t’i zëvendësojë këto banesa me banesa tetëkatëshe që do të jenë më të sigurt dhe më të përshtatshme për banim. Pasi të përfundojë projekti, do të ketë hapësirë për 1 500 banorë. Qytetarët që nuk kanë shtëpi dhe punë mund të zhvendosen në këto banesa.



ROLET

Ju jeni mësues në shkollën e vetme në këtë lagje. Keni shumë nxënës nëpër klasa, shumë më shumë se në lagjet e tjera. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?	Ju sapo keni lënë shtëpinë në fshat dhe po kërkon një vend të ri për të jetuar. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?
Ju jeni pronar i një shitoreje në lagjen "Toka". Mezi i mbulon shpenzimet për ta mbajtur biznesin funksional. Jeni të shqetësuar për nivelin e krimit në lagje. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?	Ju punoni për pastrimin dhe mirëmbajtjen e lagjes. Departamenti juaj nuk ka punëtorë mjaftueshëm. Qytetarët ankohen që ju nuk e mirëmbani lagjen si duhet. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?
Ju punoni në qendrën e vetme të mjekësisë familjare që është në lagje. Është shumë vështirë për ju të kujdeseni për 500 banorët e lagjes. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?	Ju jeni shoferja e vetme e autobusit të lagjes. Autobusi është gjithmonë i stërngarkuar me banorët që shkojnë të punojnë jashtë lagjes. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?
Ju jeni pronar i dyqanit të veshmbathjes në lagje dhe synoni të ndërtoni një fabrikë. Ju nevojiten më shumë blerës të rrobave dhe më shumë punëtorë. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?	Ju jeni rinia e lagjes dhe ndiqni mësimet në shkollën e lagjes. Vendi i vetëm që e keni për argëtim është parku i vogël. Parku nuk është i mirëmbajtur dhe është i dëmtuar. Sapo lexuat për planin e ri të komunës. Cilat janë arsyet pozitive për këtë ide? Cilat janë problemet që do t'i shkaktojë?

Titulli	Ndotja e mjedisit dhe të drejtat e fëmijëve
Qëllimi	Të mësojnë nxënësit rreth lidhshmërisë së ambientit të pastër dhe të drejtave të tyre. Të kuptojnë nga shembuj konkretë se si ndotja e ambientit ndikon në respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të tyre në mbarë botën. Të eksplorojnë të drejtën e secilit fëmijë që të rritet në një ambient të shëndetshëm.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Neni 42 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës: 2.3. Shëndeti i fëmijës garantohet duke marrë masa për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, duke marrë masa për sigurinë e produkteve ushqimore, ujit të pastër dhe duke marrë parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror; Neni 24 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve: Ju keni të drejtë për kujdes më të mirë shëndetësor të mundshëm, ujë të pijshëm të pastër, ushqim të shëndetshëm, një mjedis të pastër dhe të sigurt dhe informacion për t'ju ndihmuar si të jetoni mirë.
Materialet	Shtypi i materialit 'Rastet e ndotjes' në faqe 41 dhe prerja e tyre në katrorë. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund të lexoni nga një rast ose dy për secilin grup, ndërsa ata i shkruajnë në fletore.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Ndajini nxënësit në grupe nga 4 ose 5 veta. Varësisht nga numri i grupeve, ndajini në formë të barabartë "Rastet e ndotjes" të prera në katrorë. Nëse nuk keni printer, mund të lexoni nga një rast ose dy për secilin grup, ndërsa ata i shkruajnë në fletore. Kërkoni nga nxënësit t'i lexojnë rastet dhe t'i komentojnë shkurt, dhe tregoni që këto raste janë të bazuara në ngjarje të vërteta. 10 minuta

HAPI 2	Kërkoni nga nxënësit të identifikojnë se cilat të drejta themelore janë shkelur në rastet e tyre dhe t'i shkruajnë në një fletë. Pasi ta kenë mbaruar diskutimin, kërkoni nga një përfaqësues i grupit ta shpalosë rastin e grupit dhe të drejtat që mendojnë se janë shkelur. <i>Pas përfundimit të paraqitjeve, lexojuni këto dy nene:</i> Neni 42 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës: 2.3. Shëndeti i fëmijës garantohet duke marrë masa për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, duke marrë masa për sigurinë e produkteve ushqimore, ujit të pastër dhe duke marrë parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror; Neni 24 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve: Ju keni të drejtë për kujdes më të mirë shëndetësor të mundshëm, ujë të pijshëm të pastër, ushqim të shëndetshëm, një mjedis të pastër dhe të sigurt dhe qasje në informacion për t'ju ndihmuar si të jetoni mirë. 25 minuta
Diskutim	<i>Lexojeni këtë paragraf para nxënësve:</i> Pasi që i dëgjuam të gjitha grupet dhe ligjet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve që ndërlidhen me ambientin, çfarë mendoni: 1. Pse vazhdojnë këto të drejta të shkelen ndërkombëtarisht? (Përgjigje potenciale: zhvillimi ekonomik i vendeve të varfra, politika dhe dënime të dobëta për ata që e dëmtojnë ambientin, pajisje të vjetra si automobila, mungesë e opsioneve për riciklimin e të gjitha mbeturinave.) 2. Si mund të ndihmojmë ne për përmirësimin e kësaj situate? (Përgjigje potenciale: ngritja e vetëdijesimit, përdorimi sa më i rrallë i mjeteve që nuk riciklohen, heqja nga përdorimi i pajisjeve që shkaktojnë ndotje.) 3. Nëse në Kosovë ndotës kryesor i ajrit është përdorimi i qymyrit për ngrohje dhe elektricitet, së këndejmi veturat e vjetra, cilat janë metodat për përmirësimin e gjendjes në Kosovë? (Përgjigje potenciale: izolimi i shtëpive që të mos ketë nevojë për shumë ngrohje/ftohje, përdorimi i rrymës alternative të diellit ose erës, ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve që të përdorin transport tjetër e jo vetura etj.) Nëse keni internet në klasë, hapeni këtë faqe https://ajri.niph-rks.org/ dhe tregojuni nxënësve që tani ka matës të kualitetit të ajrit në Kosovë. 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që secili prej nesh kemi të drejtë të kemi një jetesë të mirë dhe është përgjegjësi e shtetit të na ofrojë të drejtat themelore. Përqendrimi duhet të vihet në të drejtat që cenohen ndërkombëtarisht duke mos pasur qasje në një ambient të pastër ngaqë fëmijët kanë të drejtë të kenë një jetë të shëndetshme si dhe të mund të luajnë e të dalin në rrugë pa u rrezikuar nga ndotja e ambientit.

RASTET

■ Gjatë dimrit institucionet e Kosovës bëjnë thirrje për t'i shmangur daljet në disa qytete për shkak të kualitetit të ndotur të ajrit të krijuar nga ndezja e qymyrit dhe makinat e vjetra. Familjet duhet të shikojnë së pari kualitetin e ajrit në <https://ajri.niph-rks.org/> pastaj të vendosin nëse duhet t'i lejojnë fëmijët të dalin të luajnë.

■ Në shumë vende të botës oqeanet janë të stërmeshura me toksina saqë njerëzit përreth janë duke humbur burimin e ushqimit (pasi që hanë peshq) ose janë duke ngrënë peshq që janë të kontaminuar me toksina.

■ Në Kanada ka disa liqene në të cilat lejohet të notohet vetëm nëse e kanë nivelin e ulët të ujërave të zeza. Fëmijët, para se të notojnë në ta, së pari duhet ta shikojnë nivelin e ndotjes së ujit.

■ Në disa fshatra të Kosovës bujqit nuk mund ta përdorin ujin e lumit për ujitje ngaqë është i ndotur nga mbeturinat. Shkaku i tyre po u shkaktohen dëme ekonomike dhe mungesë e ushqimit.

■ Gjatë verës mban temperaturë e lartë si rezultat i shkatërrimit të shtresës së Ozonit e cila e mbron Tokën nga rrezet ultraviolete. Fëmijët në Australi patjetër duhet të veshin një kapele që ua mbulon kokën dhe qafën për t'u mbrojtur nga rrezet e dëmshme të diellit.

■ Fëmijët që jetojnë afër kampeve ushtarake janë të ekspozuar ndaj toksinave që janë të ndërlidhura e konsiderohen shkak të numrit të madh të rasteve të kancerit të fëmijët.

Titulli	Të mësohemi si t'i ndihmojmë shokët ose shoqet e abuzuara seksualisht
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth të drejtës së tyre të mos abuzohen seksualisht dhe të mësojnë për format se si të mbrohen nga abuzimi. Të krijojnë empati rreth viktimave të mundshme të abuzimit dhe të kuptojnë që janë të mbrojtur nga shteti dhe shoqëria.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Abuzim seksual: Kur një i rritur, adoleshent ose fëmijë përdor fuqinë ose autoritetin për ta përfshirë një fëmijë në aktivitet seksual. Zakonisht abuzimi ndodh vazhdimisht, jo vetëm një herë. Format e abuzimit seksual: Fizike (prekje të padëshirueshme në vende të padëshirueshme), verbale (ngacmime me fjalë jo të përshtatshme ose me shikime të papërshtatshme), emocionale (ngacmime të njëpasnjëshme seksuale që ndikojnë në nervozë, ankth dhe frikë për fëmijët). Abuzuesi: Personi i cili abuzon me fëmijë në formë të papërshtatshme, zakonisht është dikush i njohur për fëmijën.
Materialet	Materiali “Çfarë të bëj?” të lexohet me zë në klasë
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Së pari filloni të krijoni një ambient të përshtatshëm për diskutim të një teme kaq të prekshme. Thojuni nxënësve që në klasë janë në një ambient të sigurt dhe asgjë nuk do të dalë jashtë klasës. Vazhdoni t'u shpjegoni për definicionet dhe fjalët kyçe, si dhe bëjuani të qartë që abuzimi seksual është shumë i pranishëm në botë. Viktimat kanë nevojë për mbështetje shoqërore dhe ndihmë nga të gjithë, si dhe mbrojtja nga abuzimi seksual është e drejtë e fëmijëve e mbrojtur me ligj. Jepuni pak kohë që të gjithë të kuptojnë rreth temës së aktivitetit dhe nëse kanë ndonjë koment ose pyetje. 5 minuta

HAPI 2

Filloni t'ua lexoni me zë tregimin “Çfarë të bëj?”. Pasi t'ua lexoni, kërkon nga nxënësit që individualisht të përgjigjen në këto dy pyetje duke i shkruar në fletore:

1. A duhet ta mbani këtë sekret? Pse po ose jo?
2. Çfarë mund të bëni që ta ndihmoni Trikun?

Jepuni 10 minuta kohë për përgjigje, pastaj kërkon nga nxënësit të flasin rreth përgjigjeve në grup ose në çift, varësisht se si janë të ulur.

20 minuta

HAPI 3

Pasi të kenë diskutuar në grup ose në çift, ftojini të gjithë nxënësit në klasë të përgjigjen në pyetjen e parë. Bëjuani me dije se asnjë përgjigje nuk është gabim dhe secili ka të drejtë të shprehë mendim.

1. A duhet ta mbani këtë sekret? Pse po ose jo? (Përgjigje potenciale: dëgjoni se si ndihet viktima dhe përpikuni ta inkurajoni të kërkojë ndihmë te ndonjë i rritur që të mos humbasë besimin te ju.)

Tani kërkon nga nxënësit të formulojnë një listë se si mund t'i ndihmojnë një shoku ose shoqeje që mund të jenë viktima të abuzimit seksual. Shkruajini përgjigjet në tabelë.

Sigurohuni t'i përfshini këto pika në listë:

1. Përpikuni mos ta ndërpritni kur flet dhe t'i jepni menjëherë këshilla (viktima ndoshta ka nevojë vetëm të flasë me dikë).
2. Dëgjojeni me kujdes.
3. Mos qeshni (nganjëherë qeshim me situata të sikletshme).
4. Besojini viktimës (mos dyshoni në asnjë çast nëse viktima është duke thënë të vërtetën).
5. Mos bëni thashetheme rreth rastit.
6. Ndihmojeni viktimën të flasë me një person të rritur adekuat (prindër, mësues, psikolog i shkollës, polic).
7. Përkraheni viktimën ngaqë e ka të vështirë të tregojë diçka të tillë.
8. Tregojini që ju merakoseni për të duke i ofruar ndihmë.
9. Tregojini disa herë që nuk është faji i tij/saj (viktimat kanë tendencë të ndihen fajtores, por ngacmimi seksual kurrë nuk është faj i fëmijës).

20 minuta

Koment

Mësimdhënësi duhet të krijojë një ambient të përshtatshëm dhe të rehatshëm për këtë bisedë. Sigurohuni që fëmijët të mendojnë se janë duke ndihmuar viktimën e abuzimit seksual dhe në asnjë çast nuk pretendohet që ata janë viktima. Pranojini të gjitha përgjigjet si të vlefshme nga të gjithë që marrin pjesë. Për më shumë informata se si të bisedoni me nxënësit rreth kësaj teme, ju lutem shihni raportin nga Save the Children:

https://resourcecentre.savethechildren.net/node/7749/pdf/respect_my_body_albanian.pdf

Çfarë të bëj?

Ti dhe Triku jeni duke ndenjur bashkë dhe duke biseduar për vajzën/djalin që pëlqeni. Papritmas Triku ndërron qasje dhe fillon t'ju tregojë se shoku ose shoqja e babit vjen në shtëpi kur askush nuk është aty. Triku ju tregon që ky person thotë gjëra të sikletshme seksuale dhe një herë e ka prekur në vend të papërshtatshëm. Triku nuk di se çfarë të bëjë dhe ju kërkon që t'i premtoni se nuk do t'i tregoni askujt.

Nëse ky rast është i rëndë, mund t'ua lexoni rastin tjetër.

Ti dhe Triku jeni duke ndenjur bashkë dhe duke biseduar për vajzën/djalin që pëlqeni. Papritmas Triku ndërron qasje dhe fillon t'ju tregojë për një mik të ri që ka bërë në "Snapchat". Triku ju tregon se ky person flet për gjëra seksuale dhe i kërkon fotografi nudo. Ndërkaq, ky person i ka dërguar fotografi nudo dhe kërkon që ta takojë.

Titulli	Të krijojmë një shoqëri të barabartë jodiskriminuese
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth formave të diskriminimit dhe të drejtës së secilit për të qenë i barabartë në shoqëri. Të mësohen se si të krijojnë një ambient gjithëpërfshirës dhe që i pranon të gjithë pa dallim gjinie, feje, race, besimi fetar.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Diskriminim: Trajtim i padrejtë dhe paragjykses për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë. Pjesëmarrje aktive: Pjesëmarrja në avokimin për zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e gjërave të dëmshme për shoqërinë.
Materialet	Shtypi i materialit: 'Rastet e diskriminimit' në faqe 47 dhe prerja e tyre në katrorë. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund të lexoni nga një rast për secilin grup, ndërsa ata i shkruajnë në fletore.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Filloni t'i pyetni nxënësit rreth diskriminimit.</i> - Çfarë kuptoni me diskriminim? (Përgjigje opsionale: trajtim i padrejtë dhe paragjykses për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë). - A dini ndonjë shembull të diskriminimit që e keni parë në klasë, shkollë, lagje, autobus, shitore, televizion ose diku tjetër? (Diskriminim gjinor, diskriminim në bazë të racës, diskriminim në bazë të fesë). 10 minuta
HAPI 2	Ndajini nxënësit në grupe. Shpërndajini 'Rastet e diskriminimit' te secili grup. Gjithsej janë 5 raste. Opsionale: Në rast se nuk mund t'i shtypni, lexojeni me zë secilin rast për secilin grup, ndërsa ata i shkruajnë në fletore. Kërkoni nga nxënësit t'i shkruajnë përgjigjet e tyre se çfarë do të bënin një herë individualisht për 5 minuta, pastaj të diskutojnë në grup për 10 minuta. 15 minuta

HAPI 3	Pasi të përfundojnë, të gjitha grupet t'i paraqesin rastet e tyre dhe se si do të reagonin. 10 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni me ta për pyetjet e mëposhtme:</i> • A mendoni se kemi raste të tilla të diskriminimit në shoqërinë tonë? Nëse po, cilat janë më të shpeshtat? • Çfarë mund të bëni ju që t'u ndihmoni grupeve të diskriminuara? 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore të fëmijëve është ndalimi i diskriminimit kundrejt secilit. Të gjitha institucionet kanë për detyrë ta mbrojnë secilin fëmijë nga diskriminimi.

RASTET E DISKRIMINIMIT

RASTI 1: Diskriminimi ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta

1 shtator. Andela është 7 vjeçe dhe sot do ta fillojë mësimin në klasën e parë. Ajo mund të lëvizë vetëm me karrocë. Sapo të mbërrijë në oborrin e shkollës, Andela vëren se nuk mund të hyjë në shkollë ngaqë nuk mund t'i kapërcejë shkallët me karrocë.

Ju jeni prindi i Andelës. Si do të vepronit?

RASTI 2: Diskriminimi gjinor

Disa djem janë duke luajtur futboll në park. Një vajzë afrohet dhe kërkon të luajë me ta. Njëri nga djemtë i thotë që ajo s'mund të luajë ngaqë është vajzë.

Ju jeni një nga ata djemtë duke luajtur futboll. Si do të vepronit?

RASTI 3: Diskriminimi në bazë të racës

Një djalë rom është duke pritur në stacion të autobusit. Kur vjen autobusi, shoferi nuk e lë të hyjë brenda.

Ju jeni një nga pasagjerët në autobus. Si do të vepronit?

RASTI 4: Diskriminimi në bazë të gjendjes ekonomike

Shkolla planifikon një ekskursion në Muzeun Kombëtar. Pagesa për të hyrë në muze është 2 euro për nxënës. Ata që nuk kanë për të paguar, nuk shkojnë në muze. Një shok i juaji nuk mund të vijë.

Ju e keni atë shok të bankës. Si do të vepronit?

RASTI 5: Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike

Është duke ndodhur një përleshje në oborrin e shkollës në mes të një nxënësi boshnjak dhe shqiptar. Drejtori suspendon nxënësin boshnjak. Nxënësi shqiptar nuk merr asnjë dënim.

Ju jeni zëvendësdrejtori i shkollës. Si do të vepronit?


Titulli	Dhuna në internet
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth formave të dhunës në internet dhe mundësisë së mënjanimet të saj. Të mësojnë rreth empatisë dhe dhënies së mbështetjes për viktimat nga dhuna në internet.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Sajbërdhuna: Përdorimi i pajisjeve digjitale, faqeve në internet dhe aplikacioneve për të frikësuar, dëmtuar dhe mërziur dikë. Empati: Të imagjinoni se si po ndihet dikush tjetër, ta vendosni veten në vend të dikujt tjetër.
Materialet	Lëshojeni në projektor videon https://youtu.be/jUYyph1c2xl . Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. Leximi i rastit: TIA në faqe 50 Vizatimi i materialit ‘Perspektiva’ në tabelë në faqen 51
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Lëshojeni në projektor videon rreth dhunës në internet: https://youtu.be/jUYyph1c2xl . Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. Pyetini nxënësit: 1. Çfarë ndodhi? 2. A dini raste të ngjashme të dhunës në internet? 3. Cilat mund të jenë pasojat për viktimën? 4. Si mund ta parandalojmë dhunën në internet? 10 minuta
HAPI 2	Lexojuni me zë tregimin “TIA” dhe komentet që janë të shkruara. Pyetini nxënësit se: A është kjo formë e dhunës në internet? A njihni dikë që i ka ndodhur diçka ngjashëm? 10 minuta

HAPI 3	Ndajini nxënësit në grupe. Vizatojeni në tabelë materialin ‘Perspektiva’ në faqen 53. Përcaktojeni këto role për secilin grup (Tia, mësimdhënësi, njëri nga komentuesit, prindi i Teas, drejtori i shkollës). Kërkoni nga ta t’i plotësojnë tre rreshtat e paraqitur në tabelë nga perspektiva e rolit që e kanë. Kërkoni nga secili grup t’i paraqesë pikat e tyre nga roli që kanë. 15 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni me ta për pyetjet e mëposhtme:</i> Pasi i dëgjuat perspektivat e tjera, çfarë nuk keni konsideruar nga perspektiva juaj? A ka diçka që do të shtonit? Çfarë do ta ndihmonte më shumë Tesën? Cilët njerëz janë më të dobishmit në këtë rast? 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore të fëmijëve është ndalimi i çfarëdolloj dhune ndaj tyre dhe institucionet kanë për detyrë ofrimin e kësaj të drejte. Ka shumë mundësi që disa nga nxënësit në klasë kanë qenë ose janë viktimë të dhunës në internet, andaj jeni shumë sensitiv ndaj tyre dhe përvojave të tyre.

TIA

Tia hyn në llogarinë e vet në “Instagram”. Ajo sheh që shoqja e saj Tesa ka publikuar një fotografi me të tekta bëjnë fytyra qesharake derisa hanë ushqim. Tia, gjithashtu, sheh që njerëzit me të cilët shkojnë në shkollë kanë komentuar te fotografia.

Këto janë komentet:



Tia mbyll llogarinë në “Instagram” dhe s’vijon orët mësimore për disa javë. Ajo fillon të mbajë dietë të rreptë e cila ndërkohë i shkakton probleme shëndetësore. Të gjithë janë të shqetësuar për mirëqenien e saj.

PERSPEKTIVA

Unë reagova ashtu ngaqë...	Një gjë që do të mund ta bëja ndryshe është...	Nuk më lejoi të bëja diçka ndryshe kjo gjë...

Titulli	Vajzë apo djalë
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth të drejtës së tyre për identitet pa qenë të ndikuar nga shoqëria dhe pritshmëritë e shoqërisë. Të kuptojnë dhe respektojnë dallimet personale.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Stereotip: Krijim i një mendimi për një person ose një grup njerëzish në bazë të karakteristikave që shumicën e kohës nuk janë të vërteta, p. sh.: Djemtë nuk dinë të gatujnë. Diskriminim: Trajtim i padrejtë dhe paragjykes për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë.
Materialet	Posterët 'Djemtë ose vajzat' në faqen 55 dhe 56 paraqitini në projektor. Shfaqja e videos: https://youtu.be/VjoLWvQJ1iw Opsionale: Në rast se nuk keni projektor, atëherë shkruajini vetëm thëniet në dërrasën e bardhë apo të zezë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Filloni duke i njoftuar nxënësit rreth diskriminimit gjinor dhe stereotipave, pastaj shfaqeni në projektor secilën fotografi 'Djemtë ose vajzat' dhe pas secilës pyetini nxënësit:</i> 1. Çfarë shfaq kjo fotografi? 2. A ka diçka që ju pengon në këtë fotografi? Mund ta lëshoni pastaj edhe videon duke çukitur në këtë vjeggëz https://youtu.be/VjoLWvQJ1iw dhe ta komentoni me pyetje të njëjta. Opsionale: Në rast se nuk keni projektor, atëherë shkruajini vetëm thëniet në dërrasën e bardhë apo të zezë. 10 minuta

Shkruani në tabelë: BËHU SI BURRË

Pyetini nxënësit:

1. Çfarë fjale ose pritje ju bie ndër mend kur ju pyesin se çfarë do të thotë “Bëhu si burrë” në shoqërinë tuaj? (Përgjigje potenciale: i fortë, sportist, mashkull, dominues, kryesori në familje, mos me qarë).

Shkruajini të gjitha çfarë thuhet në tabelë. Shpjegojuni që këto që janë shkruar janë një listë e sjelljeve dhe gjërave që djemtë pritët t’u përshtaten për t’u bërë burra. Tregojuni që këto janë stereotipa dhe nuk janë gjithmonë të vërteta.

HAPI 2

2. Ku i marrim këto mesazhe (stereotipa) që na tregojnë se si duhet të sillet dhe duket një burrë? (Përgjigje potenciale: prindërit, familja, televizioni, mediat sociale, filmat, shoqëria).

Shkruajini këto përgjigje në tabelë dhe bëjini me shigjetë nga ana e stereotipave duke treguar se kush i fuqizon stereotipat.

3. Si i thërrasin djemtë ose burrat që nuk u përshtaten dhe nuk i bëjnë gjërat që pritët nga ta? (Përgjigje potenciale: po qan si vajzë, i dobët si me genë vajzë). Theksojini që këto thënie lëndojnë njerëzit emocionalisht.

10 minuta

Shkruani në tabelë: BËHU SI VAJZË

Pyetini nxënësit:

1. Çfarë fjale ose pritje ju bie ndër mend kur ju pyesin se çfarë do të thotë “Bëhu si vajzë” në shoqërinë tuaj? (Përgjigje potenciale: e pafajshme, e qetë, emocionale, nënë e shtëpisë, jospportiste).

Shkruajini të gjitha çfarë thuhet në tabelë. Shpjegojuni që këto që janë shkruar janë një listë e sjelljeve dhe gjërave që vajzat pritët t’i përshtatin si pritshmëri të shoqërisë. Tregojuni që këto janë stereotipa dhe nuk janë gjithmonë të vërteta.

HAPI 3

2. Ku i marrim këto mesazhe (stereotipa) që na tregojnë se si duhet të sillet dhe duket një burrë? (Përgjigje potenciale: prindërit, familja, televizioni, mediat sociale, filmat, shoqëria).

Shkruajini këto përgjigje në tabelë dhe bëjini me shigjetë nga ana e stereotipave duke treguar se kush i fuqizon stereotipat.

3. Si i thërrasin vajzat që nuk u përshtaten dhe nuk i bëjnë gjërat që pritët prej tyre? (Përgjigje potenciale: e pakulturë, si mashkull, e rebeluar). Theksoni që këto thënie lëndojnë njerëzit emocionalisht.


10 minuta

Diskutim	<i>Diskutoni për pyetjet e mëposhtme me nxënësit në klasë:</i> • Si ndikon shoqëria në fuqizimin e këtyre stereotipave për vajzat dhe djemtë? • Cili është ndikimi kryesor i këtyre mesazheve? (Përgjigje potenciale: jetë jo e lirë, humbje e identitetit personal, ndikime në jetën e përditshme dhe në karrierë). • Si ndikojnë këto mesazhe në zhvillimin e identitetit tonë personal? (Përgjigje potenciale: identitet i dizajnuar në bazë të pritjeve të shoqërisë, ndryshim i jetës dhe gjërave që dëshironi t'i bëni për shkak të gjinisë). 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është ndalimi i diskriminimit kundrejt secilit. Gjithashtu, të drejtë themelore kanë zhvillimin e identitetit dhe personalitetit pa ndikim nga jashtë. Stereotipat krijojnë shumë barriera në jetën e përditshme dhe në profesion, sidomos për vajzat.


DJEMTË OSE VAJZAT




**Djemtë janë
doktora**




**Vajzat janë
infirmiere**



**Djemtë shkojnë
në zyrë**




**Vajzat qëndrojnë
në shtëpi**



**Djemtë janë
të fuqishëm**

**Vajzat janë
të ndjeshme**



**Djemtë shkojnë
në palestër**

**Vajzat shkojnë
në sallon bukurie**

Titulli	Shëndeti mendor
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth shëndetit mendor dhe rëndësisë së kërkimit të ndihmës në këto raste.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shëndeti mendor: Mirëqenia emocionale dhe psikologjike; lirimi nga stresi, ankthi dhe frika. Stigma: Kur shoqëria ju shikon ndryshe, ju turpëron dhe ju bën të ndiheni keq vetëm pse nuk jeni mirë me shëndetin mendor dhe kërkoni ndihmë psikologjike.
Materialet	Lëshojeni në projektor videon 'Rëndësia e shëndetit mendor' ⁴ : https://youtu.be/VBWhIsCbhKQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Lëshojeni në projektor videon 'Rëndësia e shëndetit mendor': https://youtu.be/VBWhIsCbhKQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. Pyetini nxënësit: 1. Na shpjegoni videon me disa fjalë? 2. Çfarë është shëndeti mendor? Cila është rëndësia e shëndetit mendor? 3. Cilat janë gjërat që na stresojnë më së shumti? (Përgjigje potenciale: testet, problemet familjare, problemet ekonomike etj.). 4. Cili është dallimi në mes të shëndetit mendor dhe fizik? (Përgjigje potenciale: shëndeti mendor kur ndihemi mirë, nuk ndihemi të lodhur ose të mërzitur shumë shpesh, nuk kemi stres, ndërkaq, shëndeti fizik është kur nuk kemi dhimbje të trupit). 20 minuta

⁴ Kjo video është realizuar nga programi TruAktiv i cili implementohet nga "Sbunker" dhe komuniteti ÇtruAktiv.

HAPI 2	Pyetini nxënësit se cilat janë disa nga mënyrat që relaksohen kur nuk ndihen mirë ose janë të stresuar. Kërkoni nga ta t'ju propozojnë disa metoda që mund t'i bëni në klasë, p. sh., lëshimi i muzikës, meditimi, vallëzimi. Zgjedheni idenë më të mirë që mund ta zbatoni në klasë. Lejojini për 10 minuta të relaksohen me metodën e përzgjedhur. 15 minuta
HAPI 3	Pasi të përfundojnë, pyetini nxënësit se si u ndien. Pse është e rëndësishme të relaksohen dhe të pushojnë kur ndihen të ngarkuar? 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që ndër të drejtat themelore për fëmijë janë shëndeti fizik dhe shëndeti mendor. Gjithashtu, relaksimi dhe loja janë të drejta të tjera.

Titulli	T'i kuptojmë shokët dhe shoqet me aftësi të kufizuar
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth vështirësive që i kanë fëmijët me nevoja të veçanta dhe të krijojnë përgjegjësi që t'u ndihmojnë.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Aftësi e kufizuar: Gjendje mendore ose fizike që ndikon në aftësinë e njerëzve për t'u përfshirë në një ose disa aktivitete, p. sh., shikimi, dëgjimi, ecja, leximi, mësimi, puna etj.
Materialet	Fletore dhe laps
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Pasi t'i ndani në grupe, kërkoni nga nxënësit të shkruajnë dhe t'i radhitin të gjitha gjërat që i bëjnë gjatë ditës (shkojnë në shkollë, në bibliotekë, vishen, dëgjojnë muzikë, luajnë). Pasi ta keni kompletuar listën kërkoni nga nxënësit ta shikojnë listën dhe për secilin aktivitet të imagjinojnë se si një fëmijë i verbër i bën ato gjëra gjatë ditës, pastaj kërkoni nga secili grup t'i paraqesë pikët e tyre. 15 minuta
HAPI 2	Ashtu në grupe, kërkoni nga nxënësit të: 1. Vlerësojnë kushtet e shkollës për qasje për fëmijët me aftësi të kufizuar; 2. Propozojnë mënyra se si të bëhet shkolla më lehtë e qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuar. Në minutat e fundit, secili anëtar i grupit bën paraqitjen e dy pikave. 30 minuta
Koment	Mësimdhënësi duhet të shpjegojë që krijimi i një ambienti të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuar është pjesë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Titulli	Unë dhe media
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth mbrojtjes në masmedia dhe ndikimit negativ që mund të ketë në zhvillimin e tyre akademik, personal dhe shoqëror.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Definicionet dhe fjalët kyçe	Masmedia: Duke përfshirë televizionin, reklamat, rrjetet sociale, gazetat, filmat, lojërat etj.
Materialet	Fletore dhe laps
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Paraqiteni temën dhe definojeni se çfarë është masmedia. Kërkoni nga nxënësit të mendojnë për profilin më të popullarizuar që e ndjekin në rrjete sociale. Kërkoni nga ta të listojnë:</i> 1. Pse janë të popullarizuar? 2. Si ndikojnë këto profile te ta? (Përgjigje potenciale: stili i veshjes, ushqimi, muzika, lojërat). 3. Çfarë paraqiten më shumë në profilet e tyre? 4. Çfarë nuk paraqitet në profilet e tyre nga jeta reale? (Përgjigje potenciale: çastet e hidhërimit, mërzisë, vetmisë). 10 minuta
HAPI 2	<i>Ndajini nxënësit në grupe dhe lexojuni këtë paragraf:</i> Në grupe ju duhet të krijoni diçka të popullarizuar. Për shembull, profil në rrjete sociale, reklamë, emision televiziv. Produkti juaj duhet të përshtatet me zhvillimet dhe çfarë po kërkohet për moshatarët tuaj këto ditë. Për shembull, kanal të “YouTube”-s për raportimin e lojërave në internet. Kërkoni nga secili grup të paraqesë produktin e tyre për 3 minuta. 20 minuta

Diskutim	<i>Pasi ta kenë paraqitur, diskutoni me ta për këto pyetje:</i> 1. Çfarë ju shtyri të krijoni atë produkt? Çfarë kishit parasysh? (Përgjigje potenciale: trendët, çfarë u pëlqen moshatarëve). 2. Çfarë nuk keni paraqitur gjatë lansimit të produktit? (Përgjigje potenciale: anën e errët, pjesën normale dhe reale). 3. Si mendoni që mediat ndikojnë te ju? (Përgjigje potenciale: veshja, ushqimi, lojërat, stili i jetesës). 4. A shfaqin ndonjëherë mediat anët e errëta? Nëse jo, si ndikon kjo në mirëqenien tuaj? (Përgjigje potenciale: krijimi i një realiteti të pavërtetë i cili rritë pritshmëritë e fëmijëve dhe krijon pakënaqësi).
Koment	Mësimdhënësi duhet të shpjegojë për realitetin e rrejshëm të krijuar në media dhe ta nxitë mendimin kritik të nxënësit kurdo që shohin diçka të popullarizuar, ta vënë në pikëpyetje realitetin e saj.

Titulli	Ushqehu shëndetshëm
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth të drejtës së tyre për qasje në ushqim të shëndetshëm dhe të kuptojnë përgjegjësinë që kanë kundrejt ushqimit të shëndetshëm.
Niveli	Klasa 6, 7, 8, 9
Materialet	Fletore dhe laps
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Kërkoni nga nxënësit të tregojnë se cilat janë ushqimet e shëndetshme (shkruajini në tabelë). Tani kërkoni nga nxënësit të tregojnë se cilat janë ushqimet jo të shëndetshme (shkruajini në tabelë). 10 minuta
HAPI 2	Ndajini nxënësit në grupe dhe lexojuani këtë paragraf: Në grupe ju duhet të krijoni një meny për mëngjes dhe drekë për moshatarët tuaj. Duhet të keni parasysh që ushqimet duhet t'u përgjigjen nevojave të moshatarëve tuaj për zhvillim të trupit, zhvillim të trurit, koncentrim, energji, shëndet, fuqi etj. Ju duhet të hulumtoni në internet se cilat ushqime ndihmojnë në këto gjëra. Pasi t'i listoni ushqimet, krijoni dy shujta duke i kombinuar, pastaj paraqitini në një poster. 20 minuta
HAPI 3	Nxënësit paraqesin dy shujtat e tyre duke qartësuar se për çfarë është i dobishëm secili ushqim. Në fund kërkohet që të votohet shujta më e mirë. 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes ndaj fëmijëve me kushte më të rënda ekonomike që t'i bëjë të ndihen të përfshirë.



KAPITULLI 3

Klasat 10 – 12

Kapitulli 3 i këtij doracakut përmban aktivitete për nivelin klasor 10-12 të cilat lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e fëmijëve siç parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Marrë parasysh zhvillimin kognitiv të fëmijëve nga klasa 10 deri 12, aktivitetet janë dizajnuar me qëllim që fëmijët të kuptojnë të drejtat e tyre në formë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet ofrimit të zgjidhjeve dhe alternativave për shkeljet eventuale të të drejtave. Gjithashtu, fëmijët kuptojnë përgjegjësitë e tyre për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë bashkëmoshatarët. Aktivitetet përqendrim të veçantë kanë zhvillimin emocional, kognitiv dhe praktik të fëmijëve duke i kuptuar të drejtat e tyre.

Aktivitetet në këtë kapitull kanë për qëllim shtjellimin dhe kuptimin e këtyre të drejtave themelore të fëmijëve:

- **Të drejtat themelore** si e drejta për strehë, për ushqim dhe për ambient të pastër të jetesës;
- **Pjesëmarrja aktive dhe qytetarizmi** duke theksuar nevojën e bashkëjetesës në shoqëri dhe shprehjen e mendimit të lirë;
- **Respektimi i pikëpamjes së fëmijës** duke qartësuar forma të ndryshme për marrjen e vendimeve dhe shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave;
- **Mbrojtja nga diskriminimi** duke vënë theks të veçantë te fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komunitetet pakicë, gjinia dhe gjendja shoqërore-ekonomike;
- **Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës** duke përfshirë dhunën në internet dhe abuzimin seksual;
- **Mbrojtja nga masmedia** duke qartësuar ndikimin e mediave në jetën e përditshme me qëllim mënjanimin e ndikimit;
- **Mbrojtja nga substancat** e dëmshme duke kërkuar nga vetë nxënësit t'i kuptojnë dëmet dhe të marrin përgjegjësi;
- **Loja/argëtimi dhe shëndeti** mendor duke u ofruar mundësi për lojë dhe argëtim dhe duke theksuar të drejtën e tyre për pushim.

Për ta lehtësuar punën e mësimitdhënësit, formati i të gjitha aktiviteteve është i njëjtë dhe përmban hollësi të thjeshtësuara për zhvillimin e secilit aktivitet. Përveç nivelit të njohurisë kognitive të nxënësve, po ashtu është marrë parasysh edhe qasja e mësimitdhënësve në materiale për zhvillimin e aktivitetit dhe për secilin aktivitet ofrohen opsione të cilat janë lehtë të zbatueshme. Nga mësimitdhënësi pritët që t'i modifikojë pyetjet dhe pjesë të aktivitetit në bazë të nivelit të njohurive të klasës.

Secili aktivitet përmban: (1) Titullin; (2) Qëllimin që tregon se cila e drejtë synohet të mësohet; (3) Nivelin; (4) Definicionet dhe fjalët kyçe; (5) Materialet dhe opsionet shtesë; (6) Kohëzgjatjen; (7) Përshkrimin e aktivitetit - secili aktivitet është i përshkruar me hapa përcjellës, pyetje për fëmijët dhe udhëzime të drejtpërdrejta; (8) Diskutim - pyetje shtesë për ta arritur qëllimin e aktivitetit; dhe (9) Koment - udhëzime për mësimitdhënësin se ku duhet ta vë theksin më shumë gjatë aktivitetit.

Titulli	Kërkesë për komunën
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe rreth qytetarizmit. Të kuptojnë për lidhshmërinë ndërmjet njerëzve dhe shoqërisë, si ato bashkëfunksionojnë me njëra-tjetrën në një qytetërim aktiv. Të mësohen të shprehin mendimin e tyre dhe të drejtën e tyre që të kenë opinion.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Avokim: Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shoqërisë nëpërmjet rekomandimeve publike. Bashkëjetesa: Jeta e shëndoshë e përbashkët me njerëzit në shoqëri. Pjesëmarrje aktive: Pjesëmarrja në avokimin për zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e gjërave të dëmshme për shoqërinë. Kompromisi: Arritja e një vendimi që është i pranueshëm për të gjithë. Opinion: Pikëpamje dhe mendim rreth një çështjeje të caktuar. Grupe të interesit: Një grup njerëzish që kanë interesa dhe kërkesa të përbashkëta rreth një çështjeje të caktuar.
Materialet	Shtypi i materialit (1), “Kërkesë për komunën”, faqe 68. Opsionale: Në mungesë materialeve për shtyp, mund t’i shkruani në tabelë pikat përfshirëse ‘Kërkesë për komunën’ ose t’i paraqitni në projektor.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Kërkoni nga nxënësit të mendojnë rreth një problemi urbanistik që e kanë në lagjen e tyre ose në qytetin e tyre që do të kërkonin nga komuna përkatëse për përmirësim. Opsionale: Një ditë para zhvillimit të aktivitetit, kërkoni nga nxënësit të hulumtojnë në internet rreth problemeve urbanistike në qytetin e tyre. Inkurajojini t’i ndjekin lajmet ose të hulumtojnë në gazeta rreth kësaj teme dhe t’i shikojnë reagimet e grupeve të ndryshme të interesit. 5 minuta

HAPI 2	Ndajini nxënësit në çifte ose në grupe nga tre. Shpërndajeni ‘Kërkesën për komunë’ për secilin grup. Opsionale: Në rast se nuk mund t’i shtypni, shkruajini në tabelë pikat kyçe të përfshira në ‘Kërkesën për komunë’ ose paraqitini në projektor. 3 minuta
HAPI 3	Lexojuni këta paragrafë të shkëputur nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës: Neni 40: 2. Institucionet në nivel qendror e lokal, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e hapësirave të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët. Këto masa përfshijnë: 2.1. Miratimin e kuadrit rregullues urbanistik, si dhe të akteve të organeve të vetëqeverisjes lokale për të garantuar hapësira urbane të përshtatshme dhe qasje të sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike. Kërkoni nga nxënësit që së pari të shkruajnë në pika të shkurtra: (1) problemin urbanistik, (2) kërkesën dhe propozimin për zgjidhjen e problemit dhe (3) përfituesit kryesorë nga zbatimi i këtij plani, pastaj kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një kërkesë zyrtare për komunën duke përdorur formatin e ‘Kërkesës për komunë’. 20 minuta
HAPI 4	Kërkoni nga nxënësit ta shpalosin kërkesën e tyre para klasës në pika të shkurtra duke shpalosur problemin dhe zgjidhjen që ofrojnë, pastaj votoni për kërkesën më të mirë të tyre e cila do ta përmirësonte jetën e shumicës së shoqërisë. 10 minuta

Diskutim	<i>Diskutoni me nxënësit në klasë për pyetjet e mëposhtme:</i> • A ka ndonjë grup me interesa të tjera që do t'i pengonte zbatimi i planit të propozuar nga ju? • Cili grup duhet të ketë më shumë peshë në këtë vendim? • Si është ndërruar mendimi juaj kur i dëgjuat grupet e tjera rreth problemit tuaj? 7 minuta
Aktivitet Shtesë	Për orë shtesë, ftojini ndonjë përfaqësues të komunës në panel që t'i dëgjojë kërkesat e nxënësve për zhvillime urbanistike. Nxënësit mund të dërgojnë vetë kërkesën për takim. Para takimit nxënësit shkruajnë pikat kyçe për diskutim rreth kërkesave që i kanë përpiluar gjatë aktivitetit, mënyrës së zbatimit dhe përparësitë që do t'i ofronte zhvillimi i projektit të tyre.
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që vendime të tilla merren nga komuna përkatëse vazhdimisht. Gjithashtu, mësimdhënësi duhet të shpjegojë që Ligji për të Drejtën e Fëmijës kërkon që fëmijët të kenë kënde lojërash dhe mjedise sportive, si dhe të drejtën për shprehjen e opinionit të tyre të lirë.

Kërkesë për komunë

Për: [Shkruani emrin ose drejtorinë se kujt i drejtoheni]

Nga: [Shkruani emrin tuaj ose emrin e shkollës]

Rreth: [Shkruani arsyen e kërkesës]

I/e nderuar,

PARAGRAFI 1: [Shkruani 2-3 fjali rreth kërkesës suaj, cili është problemi dhe cila është kërkesa juaj konkrete, p. sh.: Në lagjen tonë, shkak i qarkullimit të madh të veturave, nuk kemi hapësirë për të luajtur dhe jemi të rrezikuar nga automjetet sa herë që luajmë].

PARAGRAFI 2: [Shkruani në 5-6 fjali idetë se si dëshironi të ndryshoni një pjesë të qytetit dhe se si kërkesa juaj do ta përmirësonte jetën tuaj dhe të shoqërisë suaj, p. sh.: Kërkojmë nga komuna ta rrethojë hapësirën tonë të lojërave në mënyrë që automjetet mos të kenë qasje në atë pjesë dhe mos të na rrezikojnë jetën tonë].

PARAGRAFI 3: [Kërkoni më shumë respekt nga komuna që të merret parasysh kërkesa juaj dhe ofroni gatishmërinë tuaj për takim nëse kërkohet nga komuna].

Me shumë respekt,

[Emri dhe mbiemri]

[Profesioni]

[E-maili dhe numri kontaktues]

Titulli	Në këpucë të dikujt tjetër
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth pabarazisë në shoqëri dhe të krijojnë mirëkuptim për grupet e ndryshme të shoqërisë. Të kuptojnë rreth ndëshkimeve personale që disa njerëz kanë vetëm sepse i takojnë një grupi minoritar.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Minoritet: Pakicë kombëtare që jeton në një vend a në një shtet tjetër: minoriteti romë në Kosovë. Stereotip: Krijim i një mendimi për një person ose një grup njerëzish në bazë të karakteristikave që shumicën e kohës nuk janë të vërteta, p. sh.: Djemtë nuk dinë të gatujnë. Diskriminim: Trajtim i pabarabartë dhe ndryshe (në aspekt të keq) ndaj një personi apo grupi vetëm sepse i takon një tjetër race, etnie, religjioni, gjinie apo orientimi seksual. Spektri i autizmit: Një çrregullim zhvillimor që karakterizohet me vështirësi në bashkëveprimin dhe komunikimin shoqëror dhe nga modele të kufizuara ose të përsëritura të mendimit dhe sjelljes.
Materialet	Shtypi i materialit (1), “Rolet për secilin nxënës”, në faqe 72. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund t'i shkruani në fleta të vogla katrore para fillimit të orës mësimore.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Shpjegojuni që të gjithë do të vënë veten në ‘këpucë të dikujt tjetër’, pra do të imagjinojnë që jetojnë jetën e tyre. Ata duhet ta përdorin imagjinatën kur u përgjigjen pyetjeve të parashtruara. Shpërndajini rolet te të gjithë nxënësit dhe kërkonin nga ta që t'i mbajnë rolet sekrete. Janë gjithsej 20 role. Nxënësit e tjerë që nuk kanë role vëzhgojnë dhe përpiqen ta gjejnë rolin e secilit në bazë të hapave që nxënësit i bëjnë para. Nxënësit me role ngrehini në këmbë dhe renditini në një vijë të drejtë. Mund ta përdorni korridorin e shkollës ose një hapësirë më të madhe nëse klasa nuk ka hapësirë. 5 minuta

HAPI 2	Për t'u ndihmuar që të hyjnë në rol, lexojuni këto pyetje dhe kërkon nga nxënësit që të përgjigjen në mendjen e tyre. Pas çdo pyetje, pushoni pak që të kenë kohë të hyjnë në rol dhe ta parafytyrojnë rolin e tyre. • Si ka qenë fëmijëria juaj? Ku keni jetuar? A kanë punuar prindërit tuaj? • Si është jeta juaj tani? Me kënd shoqëroheni? Çfarë bëni në mëngjes, pasdite dhe në mbrëmje? • Çfarë jetese keni tani? A keni para mjaftueshëm? Ku i kaloni pushimet ose kohën e lirë? • Çfarë ju pëlqen dhe çfarë ju frikëson? 5 minuta
HAPI 3	Tregojuni nxënësve që do t'ua lexoni me zë një listë të situatave dhe ngjarjeve. Sa herë ata përgjigjen 'po' duhet të bëjnë një hap para dhe të qëndrojnë aty. Në rast se edhe për pyetjen e dytë thonë 'po', atëherë bëjnë edhe një hap para. Përndryshe, nuk duhet të lëvizin. Lexojini situatat në faqe 71 dhe pushoni pak që nxënësit të kenë kohë të mendojnë. Në fund kërkon nga të gjithë të numërojnë se sa hapa para janë. 15 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni për pyetjet e mëposhtme me të gjithë pjesëmarrësit:</i> • Si u ndjetë kur bënit një hap para? Si u ndjetë kur nuk lëviznit fare? • Për ata që bënë shumë hapa para, kur e kuptuan që të tjerët nuk po lëviznin po aq shpejt sa ata? • Sa ishte e lehtë ose e vështirë të hynin në rol? A janë të sigurt që pasqyrën për rolin e krijuar nuk e kanë bazuar në stereotipa? <i>Pyetje për vëzhguesit:</i> • A mund t'i qëlloni rolet e secilit? (Lexojini disa nga rolet). <i>Pyetje për të gjithë nxënësit:</i> • Cili mund të jetë një rast i stereotipit gjatë zhvillimit të aktivitetit? • A e pasqyron shoqërinë ky aktivitet? Si? • Cilat janë disa të drejta që u mohohen minoriteteve, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera joshumicë? • Cilët janë hapat e parë për ta adresuar pabarazinë në shoqëri? 20 minuta
Koment	Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që nxënësit të kuptojnë pabarazinë që ndodh për shkak të grupit që i takojnë, andaj distanca në mes të hapave duhet të jetë shumë e qartë.

SITUATAT

1.	Ju keni pasur gjithmonë shumë para për t'i shpenzuar si të doni.
2.	Ju keni një shtëpi të mirë dhe keni telefon personal.
3.	Ju ndiheni i/e respektuar nga të gjithë përreth jush.
4.	Ju ndiheni që opinioni juaj ka vlerë dhe njerëzit ju dëgjojnë.
5.	Ju keni mbaruar ose do ta mbaroni shkollën e mesme.
6.	Ju mund të shkoni në shkollë rregullisht.
7.	Ju keni se kënd ta pyetni për këshilla kurdo që ju nevojiten.
8.	Ju nuk jeni ndier asnjëherë i/e diskriminuar.
9.	Ju mund ta vizitoni doktorin dhe të merrni ilaçe sa herë ju nevojiten.
10.	Ju shkoni për pushime të paktën një herë në vit.
11.	Ju nuk mund t'i ftoni shokët e shoqet në shtëpi kur të doni.
12.	Ju keni një jetë interesante dhe një ardhmëri të suksesshme.
13.	Ju ndiheni që mund të mësoni dhe ta zgjidhni profesionin që dëshironi.
14.	Ju nuk frikësoheni nga ngacmimet ose sulmet në rrugë.
15.	Ju shkoni në teatër ose në kinema të paktën një herë në muaj.
16.	Ju mund të ushqeheni shëndetshëm dhe të hani çfarë të doni.
17.	Ju mund të dashuroni këdo që dëshironi.
18.	Ju mund ta përdorni internetin kur të dëshironi për të mësuar.
19.	Ju nuk mund të rrini lirshëm në shtëpi.
20.	Ju nuk keni nevojë të punoni për para.

ROLET

Ju jeni një 16 vjeçe shtatzënë.	Ju jeni një djalë nga komuniteti ashkali dhe i ndihmoni babait për punë të ndryshme.
Ju jeni 15 vjeç/e dhe vuani nga autizmi.	Ju jeni një vajzë 15 vjeçe nga komuniteti rom dhe do të martoheni pas një muaji.
Ju jeni vajza e ambasadorit amerikan në Kosovë.	Ju jeni një djalë 13 vjeç që ju kanë ngacmuar në shkollë.
Ju jeni një imigrant nga Siria dhe nuk e keni familjen në Kosovë.	Ju jeni një jetim 12 vjeç që jetoni në jetimore.
Ju jeni vajza e një afaristi të pasur.	Ju jeni një 13 vjeç me probleme në mësimnxënie.
Ju jeni 14 vjeç/e, babai juaj është alkoolist, i papunësuar. Keni dhunë në familje.	Ju jeni një 13 vjeçe dhe keni dhunë në familje.
Ju jeni një myslimane 14 vjeçe dhe bartni shaminë këtë vit.	Ju jeni djali i kryeministrit të Kosovës.
Ju jeni një këngëtare e famshme për fëmijë.	Ju jeni fëmija i dy prindërve doktorë. Jeni katolik.
Ju jeni djali i një babai boshnjak që ka një biznes të suksesshëm.	Ju jeni një serb 13 vjeç që jetoni në Prishtinë.
Ju jeni një nxënës me aftësi të kufizuar dhe përdorni karrocën për të lëvizur.	Ju jeni një vajzë 15 vjeçe që ju është publikuar një fotografi nudo në internet.
Ju jeni vetvetja.	Ju jeni vetvetja.
Ju jeni vetvetja.	Ju jeni vetvetja.

Titulli	Të mësohemi si t'i ndihmojmë shokët ose shoqet e abuzuara seksualisht
Qëllimi	Të mësohen nxënësit rreth të drejtës së tyre, të mos abuzohen seksualisht dhe të mësojnë format se si të mbrohen nga abuzimi. Të krijojnë empati rreth viktimave të mundshme të abuzimit dhe të kuptojnë që janë të mbrojtur nga shteti dhe shoqëria.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Abuzim seksual: Kur një i rritur, adoleshent ose fëmijë përdor fuqinë ose autoritetin për të përfshirë një fëmijë në aktivitet seksual. Zakonisht abuzimi ndodh vazhdimisht, jo vetëm një herë. Format e abuzimit seksual: Fizike (prekje të padëshirueshme në vende të padëshirueshme); verbale (ngacmime me fjalë jo të përshtatshme ose me shikime të papërshtatshme); emocionale (ngacmime të njëpasnjëshme seksuale që ndikojnë në nervozë, ankth dhe frikë për fëmijë). Abuzuesi: Personi i cili abuzon me fëmijë në formë të papërshtatshme, zakonisht është dikush i njohur për fëmijën.
Materialet	Fletë dhe stilolaps për shkrim
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Së pari filloni të krijoni një ambient të përshtatshëm për diskutim të një teme kaq të prekshme. Thojuni nxënësve që në klasë janë në një ambient të sigurt dhe asgjë nuk do të dalë jashtë klasës. Vazhdoni të jepni shpjegime për definicionet dhe fjalët kyçe, si dhe bëjuani të qartë që abuzimi seksual është shumë i pranishëm në botë. Viktimat kanë nevojë për mbështetje shoqërore dhe ndihmë nga të gjithë, si dhe mbrojtja nga abuzimi seksual është e drejtë e fëmijëve e mbrojtur me ligj. Jepuni pak kohë që të gjithë të kuptojnë rreth temës së aktivitetit dhe pyetini nëse kanë ndonjë koment ose pyetje. 5 minuta

HAPI 2	Kërkoni nga nxënësit të ndahen në grupe 2-3 nxënës dhe të mendojnë për një rast të abuzimit seksual të fëmijëve. Ata duhet të shkruajnë 2-3 fjali rreth rastit të abuzimit seksual që e kanë imagjinuar ose e kanë menduar. Kërkoni nga të gjitha grupet t'i paraqesin rastet e tyre. Në fund, përzgjidhni rastin më të ndjeshëm dhe më të plotë përmes votave të nxënësve. 15 minuta
HAPI 3	Pyetini nxënësit: Kush janë personat kyçë të cilët viktimë në rastin e përzgjedhur duhet t'ju kërkojë ndihmë? (Merrini shembull disa persona - prind, mësues, shok ose shoqe, motra, vëllai, daja, polici). Tani kërkoni një vullnetar/e që të luajë rolin e viktimës dhe 4-5 vullnetarë të luajnë rolin e personave të identifikuar se ku duhet viktimë të kërkojë ndihmë. Kërkoni nga viktimë që të dalë nga klasa dhe kur të hyjë brenda të kërkojë ndihmë nga personat e identifikuar si ndihmës. Shpjegojuni vullnetarëve e tjerë që kur viktimë të kërkojë ndihmë, ata nuk do ta dëgjojnë (dikush e fajëson, dikush qesh, dikush i thotë që po gënjen, dikush i thotë që viktimë është fajtor/e). Vetëm personi i fundit që mbetet i ofron mbështetje. 15 minuta

	<i>Përgjigjuni këtyre pyetjeve:</i> 1. Si është ndier viktimë kur nuk mori mbështetje? Çfarë nëse ishte ndalur te personi i parë dhe nuk kishte vazhduar më tutje? 2. Si do ta ndihmojë personi i fundit viktimën? Tani kërkoni nga nxënësit të formulojnë një listë se si mund t'i ndihmojnë një shoku ose shoqeje që mund të jenë viktimë të abuzimit seksual. Shkruajini përgjigjet në tabelë. <i>Sigurohuni t'i përfshini këto pika në listë:</i> 1. Përpikuni mos ta ndërpritni kur flet dhe të jepni menjëherë këshilla (viktimë, ndoshta, ka nevojë vetëm të flasë me dikë). 2. Dëgjojeni me kujdes. 3. Mos qeshni (nganjëherë qeshim me situata të sikletshme). 4. Besojini viktimës (mos dyshoni në asnjë çast nëse viktimë është duke thënë të vërtetën). 5. Mos bëni thashetheme rreth rastit. 6. Ndihmojeni viktimën të flasë me një person të rritur adekuat (prindër, mësues, psikolog i shkollës, polici). 7. Përkrahni viktimën ngaqë e ka të vështirë të tregojë diçka të tillë. 8. Tregojini që ju merakoseni për të duke i ofruar ndihmë. 9. Tregojini disa herë që nuk është faji i tij/saj (viktimat kanë tendencë të ndihen fajtorë, por ngacmimi seksual kurrë nuk është faji i fëmijës). 10 minuta
Diskutim	Koment Mësimdhënësi duhet të krijojë një ambient të përshtatshëm dhe të rehatshëm për këtë bisedë. Sigurohuni që fëmijët të mendojnë se janë duke ndihmuar viktimën e abuzimit seksual dhe në asnjë çast nuk pretendohet që ata janë viktimë. Pranoni të gjitha përgjigjet si të vlefshme nga të gjithë që marrin pjesë. Për më shumë informacione se si të qaseni kësaj teme me nxënësit, ju lutem shikoni: https://resourcecentre.savethechildren.net/node/7749/pdf/respect_my_body_albanian.pdf

Titulli	Të krijojmë një biznes të barabartë jodiskriminues
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth formave të diskriminimit dhe të drejtës së secilit për të qenë i barabartë në shoqëri. Të mësohen se si të krijojnë një ambient gjithëpërfshirës dhe që i pranon të gjithë pa dallim gjinie, feje, race, besimi fetar.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Diskriminim: Trajtim i padrejtë dhe paragjykes për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë. Pjesëmarrje aktive: Pjesëmarrja në avokimin për zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e gjërave të dëmshme për shoqërinë. Gjithëpërfshirje: Përfshirja e të gjithëve në një grup pa marrë parasysh dallimet individuale.
Materialet	Fleta, laps dhe markerë me ngjyra për poster
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	<i>Filloni t'i pyesni nxënësit rreth diskriminimit.</i> - Çfarë kuptoni me diskriminim? (Përgjigje opsionale: trajtim i padrejtë dhe paragjykes për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë). - A dini ndonjë shembull të diskriminimit që e keni parë në klasë, shkollë, lagje, autobus, shitore, televizion ose diku tjetër? (Diskriminim gjinor, diskriminim në bazë të racës, diskriminim në bazë të fesë). - Cilat janë grupet më të diskriminuara në Kosovë? (Përgjigje potenciale: vajzat/gratë, komunitetet pakicë rom, ashkali dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuar, personat e moshuar etj.). 10 minuta

HAPI 2	Lexojuni këtë paragraf: Shumë biznese dhe organizata të suksesshme kanë politika për gjithëpërfshirje dhe mosdiskriminim. Kjo do të thotë që ato premtojnë se do t'i trajtojnë të gjithë barabartë. Paramendojeni që jeni pronar/e i një biznesi ose shoqate të tillë. 1. Krijoni një politikë/akt gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues. Duhet t'u shpjegoni se si do t'i trajtoni të gjithë konsumatorët dhe stafin tuaj. Shkrimi duhet të përfshijë (shkruajini në tabelë këto tri pika): Një fjali duke shpjeguar se kush është i mirëseardhur; Si do t'i trajtoni rastet e diskriminimit dhe si do ta ndaloni diskriminimin në biznesin apo shoqatën tuaj; Një mesazh pozitiv dhe mikpritës për të gjithë vizitorët e biznesit apo shoqatës suaj. 20 minuta
HAPI 3	Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarë paraqesin biznesin apo shoqatën e tyre dhe politikat e tyre gjithëpërfshirëse. Lejojeni për diskutim dhe pyetje shtesë paraqitësin pas secilës paraqitjeje. 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është ndalimi i diskriminimit kundrejt secilit. Të gjitha institucionet kanë për detyrë ta mbrojnë secilin fëmijë nga diskriminimi.

Titulli	Vetëm sepse jam nga komuniteti rom, ashkali ose egjiptian
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth pabarazisë gjinore në të gjitha fushat e shoqërisë dhe jetesës.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shoqëria: Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rreth, qytet, apo shtet pa dallim gjinie, etnie, feje. Diskriminim: Trajtim i padrejtë dhe paragjykes për kategori të ndryshme të njerëzve, më së shumti duke u bazuar në gjini, religjion, etni, moshë. Racizëm: Diskriminim, paragjykim dhe mohim i të drejtave ndaj njerëzve sepse i takojnë një race tjetër. Gjithëpërfshirje: Përfshirja e të gjithëve në një grup pa marrë parasysh dallimet individuale.
Materialet	Lëshojeni në projektor videon ‘Të barabartë, veç jo aq shumë’⁵: https://youtu.be/1uCQNERmoe0 Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Lëshojeni në projektor videon ‘Të barabartë, veç jo aq shumë’: https://youtu.be/1uCQNERmoe0 Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. Pyetini nxënësit: 1. Na shpjegoni me disa fjalë videon? 2. Cilat ishin rastet konkrete të diskriminimit në bazë të racës? 3. A kishte raste të shkeljes së të drejtave themelore? Cilat ishin ato? (Përgjigjet të mundshme: shkollimi, shtëpia, uji i pastër, rryma, ushqimi, martesë e hershme). 4. Çfarë dallon komuniteti rom nga komuniteti juaj? (Kultura, traditat). 5. Çfarë keni të përbashkët? 6. Si mund të ndihmoni në eliminimin e racizmit ndaj komunitetit rom në Kosovë? 20 minuta

⁵ Kjo video është realizuar nga programi TruAktiv i cili implementohet nga “Sbunker” dhe komuniteti ÇtruAktiv.

HAPI 2	<i>Ndajini nxënësit në grupe dhe lexojuani paragrafin më poshtë:</i> Ju jeni deputet i Kuvendit të Kosovës dhe e keni parë këtë video me raste konkrete të racizmit. Tani ju e keni për detyrë të shkruani një plan se si ta parandaloni dhe ta ndaloni plotësisht racizmin në shkolla dhe në shoqëri. <i>15 minuta</i>
HAPI 3	Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarë paraqesin politikat e tyre dhe idetë e tyre për ta luftuar racizmin. Lejojeni për diskutim dhe pyetje shtesë paraqitësin pas secilës paraqitjeje. <i>10 minuta</i>
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është ndalimi i diskriminimit kundrejt secilit. Të gjitha institucionet kanë për detyrë ta mbrojnë secilin fëmijë nga diskriminimi.

Titulli	Shëndeti mendor
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth shëndetit mendor dhe rëndësisë së kërkimit të ndihmës në këto raste.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Shëndeti mendor: Mirëqenia emocionale dhe psikologjike, lirimi nga stresi, ankthi dhe frika. Stigma: Kur shoqëria ju shikon ndryshe, ju turpëron dhe ju bën të ndiheni keq vetëm pse nuk jeni mirë me shëndetin mendor dhe kërkoni ndihmë psikologjike.
Materialet	Lëshojeni në projektor videon ‘Rëndësia e shëndetit mendor’ ⁶ : https://youtu.be/VBWhIsCbhKQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Lëshojeni në projektor videon ‘Rëndësia e shëndetit mendor’: https://youtu.be/VBWhIsCbhKQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. Pyetini nxënësit: 1. Na shpjegoni videon me disa fjalë? 2. Çfarë është shëndeti mendor? Cila është rëndësia e shëndetit mendor? 3. Cilat janë gjërat që na stresojnë më së shumti? (Përgjigje potenciale: testet, problemet familjare, problemet ekonomike etj.). 4. Kur duhet të kërkojmë ndihmë? Pse e kemi të vështirë të kërkojmë ndihmë te psikologu? (Përgjigje potenciale: stigma dhe frika që do të përqeshemi në shoqëri, frika që do të na quajnë të çmendur). 20 minuta

⁶ Kjo video është realizuar nga programi TruAktiv i cili implementohet nga “Sbunker” dhe komuniteti ÇtruAktiv.

HAPI 2	<i>Ndajini nxënësit në grupe dhe lexojuani paragrafin më poshtë:</i> Ju jeni përfaqësues i shoqërisë civile dhe keni për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të shoqërisë për shëndetin mendor. Krijoni një poster me të gjitha të dhënat e nevojshme për shëndetin mendor i cili përfshin: 1. Mesazh pozitiv për shëndetin mendor dhe shpjegim të shkurtër se çfarë është shëndeti mendor; 2. Një thënie përkrahëse dhe inkurajuese si: “Nuk je vetëm”, “Nuk është marre të kërlesh ndihmë”; 3. Kontaktoni psikologun e shkollës. 15 minuta
HAPI 3	Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarë paraqesin posterët e tyre dhe idetë e tyre për të luftuar stigmën. Lejojeni për diskutim dhe pyetje shtesë paraqitësin pas secilës paraqitjeje. 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është shëndeti fizik dhe shëndeti mendor. Luftimi i stigmës për të kërkuar ndihmë nga psikologët është e domosdoshme për një jetë të shëndoshë.

Titulli	Ndikimi i mediave
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth mbrojtjes nga masmedia dhe ndikimit negativ që mund të ketë në zhvillimin e tyre akademik, personal dhe shoqëror.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Masmedia: Duke përfshirë televizionin, reklamat, rrjetet sociale, gazetat, filmat, lojërat etj.
Materialet	Shenja '+18' në faqe 84 të shfaqet në projektor ose të vizatohet në tabelë. Posterët 'Vajzat në reklama' në faqe 85, 86, 87 paraqiten në projektor. Opsionale: Në rast se nuk keni projektor, atëherë ia tregoni klasës nga libri një nga një.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Tregojuni nxënësve rreth ndikimit të masmedias në zhvillimin e tyre dhe në përditshmërinë e tyre. Për të filluar temën më lehtë, pyetini: 1. A mendoni se kur vendosni ku të shkoni për të pirë kafe, nuk jeni të ndikuar aspak nga media? (Numërojeni sa mendojnë po e sa jo). 2. Si vendosni se ku shkoni për të pirë kafe? (Përgjigje potenciale: i shohin postimet e shokëve dhe shoqeve në rrjete sociale, i shohin reklamat). 3. Sa mendoni që ndikon media në vendimet tuaja të përditshme? Listoni disa nga shembujt. (Përgjigje potenciale: stilin e veshjes, dukjen e trupit duke ushtruar në palestër dhe duke mbajtur dietë, vendet se ku të ha dhe çfarë të ha, vendin për pushim). 4. A mendoni se mediat kanë ndikim në zhvillimin e personalitetit tuaj? (Përgjigje potenciale: ndikimi shoqëror përmes mediave – muzikë që degradon vajzat dhe kërkon nga djemtë të përdorin lëndë narkotike, definimi se çka është 'in' ose në modë, blogerët e ndryshëm që diktojnë stilin e jetesës). Shfaqni shenjën (+18) në faqe 84. Pyetini nxënësit: 1. Pse është kjo shenjë në disa kanale televizive? (Përgjigje potenciale: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës i detyron televizionet që të shfaqin këtë shenjë në rast se programi nuk është i përshtatshëm për moshën nën 18-vjeçare ngaqë ka përmbajtje narkotike, erotike dhe dhunë psikike ose fizike. Kjo bëhet për shkak të ndikimit të mediave që kanë në zhvillimin e fëmijëve deri në moshën 18-vjeçare). 10 minuta

HAPI 2	Paraqitini një nga një posterët reklamues në projektor (ose i shfaqni nga libri për të gjithë nxënësit në klasë). Lexojuni këta paragrafë: <i>Këto janë disa reklama të cilat janë bërë ndër vite.</i> 1. E para është nga një kompani e pastrimit. Çfarë nuk shkon në këtë reklamë? (Përgjigje potenciale: diskriminimi gjinor duke e konsideruar gruan vetëm si pastruese). 2. E dyta nga kompania BIC. Çfarë nuk shkon në këtë reklamë? (Përgjigje potenciale: diskriminimi gjinor, pritshmëritë se si duhet të sillen vajzat, mendimi që vetëm meshkujt dinë të mendojnë dhe të jenë pronarë). 3. E treta kompani për makineri të qepjes. Çfarë nuk shkon në këtë reklamë? (Përgjigje potenciale: theksimi që vajzat nuk janë të denja për asgjë, por vetëm për qepje). Pasi i shikuat këto tri reklama, cili është ndikimi i mediave në diskriminim gjinor? Si ndikon ajo në zhvillimin e personalitetit tuaj? (Përgjigje potenciale për djemtë: i kanë këto pritshmëri për vajzat dhe vazhdojnë diskriminimin ndaj tyre; përgjigje nga vajzat: ndihen të diskriminuara dhe kjo ndikon në zhvillimin e tyre personal). 15 minuta
HAPI 3	Kërkoni nga nxënësit të punojnë në çifte dhe të mendojnë për rastet kur mediat në Kosovë ose të huaja kanë ndikim në zhvillimin e tyre personal dhe ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Lejojuani përdorimin e telefonit për gjetje të provave në internet, nëse është e nevojshme. Materialet mund të përfshijnë: 1. Këngë; 2. Fotografia; 3. Reklama; 4. Filma ose seriale; 5. Artikuj etj. Jepuni 10 minuta kohë për hulumtim, pastaj kërkoni nga nxënës vullnetarë të ndajnë me të tjerët shembujt e tyre. Opsionale: Nëse nuk keni internet, atëherë jepuni detyrë shtëpie dhe shtyjeni këtë diskutim për orën e ardhshme. 20 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është ruajtja nga masmediat. Shembuj të shumtë janë nga tekstet e këngëve, shfaqja e artikujve dhe pamjeve të ndryshme erotike në internet dhe në televizion, reklama diskriminuese etj.



KOMPANIA E PASTRIMIT: REKLAMË

Për këtë 8 mars,
Kthehu te puna
që ja vlen me
së shumti.



**Mr.
Clean**

©2011 P&G
www.mrclean.com

KOMPANIA BIC: REKLAMË

Duku si vajzë
Sillu si zonjë
Mendo si një djalë
Puno si pronar



#HappyWomensDay



KOMPANIA PËR QEPJE: REKLAMË



Titulli	Mbrojtja nga substancat e dëmshme
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth të drejtës së tyre për të qenë të shëndetshëm dhe përgjegjësisë së tyre për t'i mënjeluar substancat e dëmshme.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Substancat e dëmshme: Substancat narkotike, alkooli, produktet e duhanit, produktet toksike.
Materialet	Nga një balon për secilin nxënës. Në mungesë të balonave mendoni për ndonjë gjë tjetër që mund ta kenë të gjithë në klasë. Lëshojeni në projektor videon 'Ndikimi i kanabisit tek adoleshentët': https://youtu.be/kbXJrtKHIBQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkoni nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Bëjuani një hyrje të shkurtër rreth temës: Sot do të flasim për lëndët narkotike në veçanti, për efektet e përdorimit dhe si ta ndihmojmë dikë që ka probleme me lëndë narkotike. Fillimisht e kemi një lojë për të gjithë. Para jush secili keni nga një balon (ose një mjet tjetër që vendosni ju). E fryni balonën dhe me marker shkruani në të emrin e më të dashurit tuaj (nënës, babit, motrës, një familjari, shokut ose shoqes). Pasi të keni përfunduar të gjithë, filloni ta hidhni balonën, por mos e lini asnjëherë të bie në tokë. Në çastin që bie në tokë, ju keni lënduar më të dashurit tuaj që ua keni shkruar emrin. Lërimi ta mbajnë balonën në ajër për 2-3 minuta. Pastaj pyetini: 1. Sa ishte vështirë të mbani dikë kaq të rëndësishëm për ju në ajër pa u ndalur? Si u ndjetë? 2. Çfarë ndodh me dikë që pi marijuanë? (Përgjigje potenciale: i humbin ndjenjat, qeshin, të uritur). Tani kërkoni nga nxënësit të mbajnë balonat lart, por pa i përdorur duart. Shpjegojuni që në momentin e marrjes së drogës i humbin ndjenjat dhe funksionin e të gjithë trupit – njëjtë sikur të mos mund t'i përdorin duart për të mbajtur në ajër dhe për mos të lënduar më të dashurit e tyre. 15 minuta

HAPI 2	Lëshojeni në projektor videon ‘Ndikimi i kanabisit tek adoleshentët’: https://youtu.be/kbXJrtKHIBQ Opsionale: Në mungesë të internetit dhe të pajisjeve, kërkonit nga fëmijët ta shikojnë në shtëpi ose ta lëshojnë në telefonat e tyre në klasë nëse kanë. <i>Pyetini nxënësit:</i> 1. Na shpjegoni videon me disa fjalë? 2. Si është bërë hulumtimi? (Përgjigje: me mijëra adoleshentë nga Kanada që kanë konsumuar marijuanë për katër vjet). 3. Cili është ndikimi i marijuanës në zhvillimin mendor? (Përgjigje: ndikim në rezultate akademike, harresë, humbje të ndjenjave). <i>Ndajini nxënësit në grupe dhe lexojuni paragrafin më poshtë:</i> Ju jeni përfaqësues i shoqërisë civile dhe keni për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të shoqërisë për të kërkuar ndihmë nëse ka problem me përdorimin e lëndëve narkotike. Krijoni një ide se si do të ishte më lehtë të ndihmoni dikë që e njihni dhe që ka probleme me përdorim të lëndëve narkotike. 15 minuta
HAPI 3	Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarë paraqesin idetë e tyre. Lejojeni për diskutim dhe pyetje shtesë paraqitësin pas secilës paraqitjeje. 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që ndër të drejtat themelore për fëmijë janë shëndeti fizik dhe shëndeti mendor, duke përfshirë mbrojtjen nga qasja dhe ekspozimi i substancave të dëmshme.

Titulli	Dhuna në internet
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth formave të dhunës në internet dhe mundësisë së mënjanimi të saj. Të mësojnë rreth empatisë dhe dhënies së mbështetjes për viktimat nga dhuna në internet.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Sajbërdhuna: Përdorimi i pajisjeve digjitale, faqeve në internet dhe aplikacioneve për të frikësuar, dëmtuar dhe mërëzitur dikë. Empati: Të imagjinoni se si po ndihet dikush tjetër, të vendosni veten në vend të dikujt tjetër.
Materialet	Leximi i rastit: MIRA në faqe 92. Shtypi i 'Roleve' në faqe 93. Opsionale: Në mungesë të materialeve për shtyp, mund t'i shkruani në fleta të vogla katrore para fillimit të orës mësimore.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	Filloni duke paraqitur temën rreth dhunës në internet. Pyetini nxënësit nëse kanë raste që kanë dëgjuar ose u ka ndodhur atyre rreth dhunës në internet. 10 minuta
HAPI 2	Lexojuni me zë rastin "MIRA". Tregojuni nxënësve që kjo është ngjarje e vërtetë, por e përshtatur, e cila ka ndodhur në një shkollë të Kosovës. Emri është imagjinar. Pyetini nxënësit: • Si ndiheni pasi dëgjuat këtë rast? • Kush është më shumë fajtor në këtë rast? • Cilat mund të jenë pasojat e dhunës në internet? 10 minuta

HAPI 3	<i>Ndajini nxënësit në grupe. Shpërndajeni nga një rol për secilin grup. Kërkoni nga nxënësit t'u përgjigjen këtyre pyetjeve nga roli i tyre:</i> 1. Si po ndihem? 2. Çfarë mund të bëj për eliminimin e kësaj situatë? 3. Si kisha mundur ta parandaloj këtë situatë? 4. Nga kush më duhet të kërkoj ndihmë? Jepuni kohë 15 minuta për përgjigje grupeve, pastaj kërkoni nga secili grup të lexojnë rolin e tyre dhe përgjigjet përkatëse. 25 minuta
Diskutim	<i>Diskutoni për pyetjet e mëposhtme me nxënësit në klasë:</i> • Pasi i dëgjuat rolet e tjera, çfarë nuk keni konsideruar nga roli juaj? A ka diçka që do të shtonit ose do të ndryshonit? • Çfarë mesazhi keni për viktimat si MIRA dhe për personat e tjerë që publikojnë fotografi të pahijshme për t'u tallur me dikë? 10 minuta
Koment	Mësimdhënësi mund të shpjegojë që një ndër të drejtat themelore për fëmijë është ndalimi i çfarëdolloj dhune ndaj tyre dhe institucionet kanë për detyrë ofrimin e kësaj të drejte. Ka shumë mundësi që disa nga nxënësit në klasë kanë qenë ose janë viktimë të dhunës në internet, andaj jeni shumë sensitiv ndaj tyre dhe përvojave të tyre.


MIRA

MIRA është një vajzë 16 vjeçe, shumë e popullarizuar në rrjete sociale. MIRA flet me një djalë në paralele i cili i pëlqen. Duke folur në “Snapchat”, djali i bën shumë presion duke i kërkuar t’i dërgojë fotografi nudo nëse dëshirojnë ta vazhdojnë bisedën. MIRA fillimisht refuzon, por djali e bind t’i besojë se fotografia do të zhduket nga “Snapchat”-i. MIRA, më në fund, bindet dhe i dërgon një fotografi gjysmë nudo djalit. Për këtë gjë MIRA menjëherë ndërron mendje, por tash ishte vonë.

Të nesërmen djali kërkon nga MIRA të takohen dhe të dalin bashkë. Në të kundërt, ai do t’ia publikojë fotografinë të cilën e kishte fotografuar me një telefon tjetër në “Snapchat”. MIRA e refuzon dhe fillon të frikësohet. Pas disa orësh, shoqja e saj, ELTA, i dërgon fotografinë e INNËS në mesazh dhe i tregon që fotografia është publikuar nga një faqe ‘fake’ (false) në “Instagram”. MIRA bashkë me shoqet hyjnë menjëherë në faqe dhe e raportojnë faqen e cila mbyllet pas disa orësh.

Të nesërmen MIRA shkon në shkollë dhe sheh që fotografia e saj është shtypur disa herë dhe është ngjitur në murin e shkollës. MIRA kthehet menjëherë në shtëpi dhe i tregon nënës, kurse frikësohet t’i tregojë babait.

MIRA detyrohet ta ndërrojë shkollën dhe gjithë stilin e jetesës. Në një çast tenton t’i japë fund jetës nga presioni dhe hidhërimi që ndien.



ROLET

MIRA

Ju jeni viktimë e dhunës në internet. Ndiheni që nuk keni më dëshirë të jetoni. Nuk mund të dilni në qytet pa ju shikuar të gjithë. Keni ndërruar shkollën.

DJALI

Ndiheni mirë një herë dhe mendoni se vetëm po bënit shaka. E keni dërguar fotografinë të shokët vetëm për të treguar që jeni i zoti me vajza. Një nga shokët e ka hapur faqen joreale. Ju nuk keni pasur për qëllim publikimin e fotografisë, vetëm keni dashur ta frikësoni INNËN.

SHOKU

Ju e keni krijuar faqen joreale dhe e keni publikuar fotografinë. Keni menduar që kjo do t'ju bëjë të ndiheni mirë ngaqë është vetëm shaka. Keni dëgjuar që MIRA ka tentuar të bëjë vetëvrasje.

NËNA

MIRA jua tregoi të gjitha, edhe fotografinë. Jeni e tmerruar nga rasti. E keni gjetur INNËN në banjë pa ndjenja ngaqë ka tentuar t'ia marrë jetën vetes.

DREJTORI

Ju keni parë fotografitë në shkollë dhe duhet të ndërmerreni diçka patjetër. Ky rast, shpërndarja e fotografive erotike të fëmijëve, konsiderohet krim në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe dënohet me ligj.

Titulli	Feja dhe besimi
Qëllimi	Të kuptojnë nxënësit rreth lirisë për fe dhe të identifikojnë metoda për të pranuar fetë e tjera.
Niveli	Klasa 10, 11, 12
Definicionet dhe fjalët kyçe	Besim: Diçka që besoni në të Feja: Grup i besimeve se përse jemi në tokë, qëllimin tonë jetësor, çfarë ndodh pasi të vdesim, çfarë është morale dhe çfarë është e shenjtë.
Materialet	'Festat Zyrtare' në faqen 95 të shfaqet në projektor ose të shkruhet në tabelë.
Kohëzgjatja	45 minuta
Përshkrimi i aktivitetit	
HAPI 1	'Festat Zyrtare' në faqen 95 të shfaqet në projektor ose të shkruhet në tabelë. Pyetini nxënësit: 1. Cilat nga këto festa zyrtare janë festa fetare? Cilës fe i takon secila? 2. Pse janë festa zyrtare? (Përgjigje potenciale: ngaqë është e drejtë e secilit qytetar t'i festojë festat e tyre fetare). 10 minuta
HAPI 2	Ndajini nxënësit në grupe. Pyetini nxënësit se cilat janë besimet fetare kryesore në Kosovë? (Përgjigje: feja islame, ortodokse dhe katolike), pastaj kërkoni nga secili grup të mendojnë, hulumtojnë dhe të shkruajnë: 1. Cilat janë karakteristikat kryesore të secilit besim fetar? 2. Çfarë kanë të përbashkët? Çfarë dallojnë nga njëri-tjetri? 20 minuta
Diskutim	Diskutoni me të gjithë nxënësit për pyetjen e mëposhtme: • A duhet të lejohet praktikimi i fesë në shkolla? (P. sh., veshja e shamisë për vajzat, vënia e kryqit, falja e namazit në shkollë). 15 minuta
Koment	Mësimdhënësi duhet të shpjegojë që nuk ka përgjigje të gabuar - të gjitha besimet fetare respektohen njëjtë dhe duhet të ketë tolerancë për secilën. Mësimdhënësi duhet të kujdeset për mbajtjen e debatit në nivel të duhur dhe të përqendrohet te promovimi i tolerancës fetare.

FESTAT ZYRTARE

Festat zyrtare në Republikën e Kosovës për vitin 2021
Službeni praznici u Republici Kosova za 2021 god.

Festat zyrtare në pajtim me nenin 2 të Ligjit nr. 03/L-064, për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, janë:
Službeni praznici u skladu sa članom 2. Zakona br.03/L-064, o službenim praznicima u Republici Kosova, su:

Nr.	Festat Zyrtare Službenih prazici	Dita/Data e festës Dan/Datum praznika	Dita/Data e pushimi Dan/Datum odmora
1.	Viti i Ri Nova godina	E premte 01 janar Petak 01 januar E shtunë 02 janar Subota 02 januar	E premte 01 janar Petak 01 januar E hënë 04 janar Ponedeljak 04 januar
2.	Krishtlindjet ortodokse Pravoslavni Božić	E enjte 07 janar Cetvertak 07 januar	E enjte 07 janar Cetvertak 07 januar
3.	Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës Dan Nezavisnosti Republike Kosova	E mërkure 17 shkurt Sreda 17 februar	E mërkure 17 shkurt Sreda 17 februar
4.	Pashkët Katolike Katolički Uskrs	E diel 04 prill Nedelja 04 april	E hënë 05 prill Ponedeljak 05 april
	Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës Dan Ustava Republike Kosova	E premte 09 prill Petak 09 april	E premte 09 prill Petak 09 april
5.	Dita Ndërkombëtare e Punës Medjunarodni Dan Rada	E shtunë 01 maj Subota 01 maj	E hënë 03 maj Ponedeljak 03 maj
7.	Pashkët Ortodokse Pravoslavni Uskrs	E diel 02 maj Nedelja 02 maj	E martë 04 maj Utorak 04 maj
8.	Dita e Evropës Dan Evrope	E diel 09 maj Nedelja 09 maj	E Hënë 10 maj Ponedeljak 10 maj
9.	Bajrami i Madh, dita e parë Fiter Bajram, prvi dan	E enjte 13 maj Cetvertak 13 maj	E enjte 13 maj Cetvertak 13 maj
10.	Bajrami i Vogël, dita e parë Kurban Bajram, prvi dan	E martë 20 korrik Utorak 20 jul	E martë 20 korrik Utorak 20 jul
11.	Krishtlindjet Katolike Katolički Božić	E shtunë 25 dhjetor Subota 25 decembar	E hënë 27 dhjetor Ponedeljak 27 de- cembar



KAPITULLI 4

Kuiz

Kuizi është interaktiv për të gjithë nxënësit.

Janë tri forma që mund ta zhvilloni kuizin varësisht prej burimeve që keni:

1. Kuizi online. Ju nevojitet kabineti me kompjuterë dhe internet. Varësisht prej hapësirës që keni, mund t'i ndani nxënësit në grupe ose individualisht për mbajtjen e kuizit. Për më shumë informata se si ta përdorni kuizin, shikojeni faqen 98. Klikoni në vjegëzën <https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

Idë shtesë: Mund të kërkonti nga nxënësit të përfundojnë kuizin edhe në shtëpi duke u qasur nëpërmjet vjegëzës së mësipërme dhe duke shkruar emrin e tyre. Pikët e mbledhura për secilin nxënës do t'ju shfaqen automatikisht.

2. Shtypi i kuizit. Kuizi në faqe 101-106 shtypet dhe shpërndahet. Kuizi mund të mbahet individualisht ose në grupe.

3. Shfaqja e pyetjeve në projektor. Shfaqini pyetjet në projektor dhe kërkonti nga nxënësit t'i shkruajnë përgjigjet e sakta në fletore.


Koment: Pas përfundimit të kuizit shkoni me radhë në secilën pyetje dhe komentojini me të gjithë nxënësit në klasë përgjigjet e sakta.

Hapi 1

Klikoni linkun:

<https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

pastaj “START A LIVE QUIZ” dhe pastaj “CLASSIC”.




Pastaj kyçuni duke klikuar “Continue with Google ose Microsoft” varësisht se çfarë e-maili keni, ose shkruani e-mailin me Sign up with email. Është e rëndësishme të regjistroheni në mënyrë që të ruani rezultatet e nxënësve, në të kundërt mund të vazhdoni edhe pa e-mail duke klikuar “Skip for Now”.

Pastaj, nëse dëshironi të mbani kuizin në grupe, përzgjidhni “TEAM” ose nëse dëshironi të mbani kuizin individualisht, përzgjidhni “CLASSIC” dhe në fund klikoni “CONTINUE”.




Do t'ju shfaqet ky kod të cilin duhet t'ua jepni nxënësve. Pasi t'ua jepni kodin, klikoni "START".

4




Pastaj kërkoni nga nxënësit të kyçen në vjegëzën <https://quizizz.com/join?gc=455768&source=liveDashboard> ose në <https://quizizz.com/>. Në anën e djathtë sipër, kërkoni që ta klikojnë "ENTER CODE" dhe ta shtojnë kodin që iu paraqitet.

5




Ta shtojnë kodin tek "ENTER A JOIN CODE" dhe pastaj të klikojnë "JOIN".

6



Pasi të fillojë kuizi, ju mund të shihni se kush është kyçur dhe nga sa pikë kanë.

6






Të drejtat e fëmijëve

20 Pyetje

20 Pyetje


1.



Cila e drejtë paraqitet
në fotografi?

- | | |
|--|---|
| ☐ a) E drejta për të pasur emër | ☐ b) Të gjithë kanë të drejta të barabarta |
| ☐ c) E drejta për të pushuar | ☐ d) E drejta për të pasur opinion |


2.



Cila e drejtë paraqitet
në fotografi?

- | | |
|---|---|
| ☐ a) E drejta për mirëqenie dhe kujdes | ☐ b) E drejta për të pasur opinion |
| ☐ c) E drejta për të pushuar | ☐ d) E drejta për edukim |

3.



Fotografia do të thotë që ju keni
të drejtë të kini:

- | | |
|-------------------------------------|-----------------------------------|
| ☐ a) Shkollë | ☐ b) Shokë |
| ☐ c) Familje | ☐ d) Maska |

4. Cila nga këto është e drejtë e fëmijëve?

- | | |
|--|---|
| ☐ a) Një edukim sportiv | ☐ b) Familje të dashur dhe mbështetëse |
| ☐ c) Dhurata për ditëlindje | ☐ d) Të bëjnë çfarë të duan |

5. Kjo e drejtë është për:



- | | |
|--|---|
| ☐ a) Të luajtur | ☐ b) Të ngrënë çfarë të doni |
| ☐ c) Mirëkuptim | ☐ d) Ushqim të shëndetshëm |

6. Fëmijët kanë të drejtë të kenë:

- | | |
|---|--|
| ☐ a) Ujë të pastër | ☐ b) Kafshë shtëpiake |
| ☐ c) Telefon mobil | ☐ d) Dhomë personale |

7. Cila nga këto është e drejtë për fëmijët?

- | | |
|---|---|
| ☐ a) Veturë | ☐ b) Vëlla ose motër |
| ☐ c) Të shkojnë në universitet | ☐ d) Shëndetësia |

8.



Kjo e drejtë është për:

☐

a) Shtëpi

☐

b) Lojëra pa fund

☐

c) Motër ose vëlla

☐

d) Para sa të duash

9.

Pse janë krijuar të drejtat e fëmijëve?

☐

a) Sepse fëmijët nuk mund të punojnë

☐

b) Sepse fëmijët nuk dinë


☐

c) Për shkak të moshës së fëmijëve

☐

d) Sepse fëmijët jetojnë në varfëri

10.



Cila e drejtë paraqitet në fotografi?

☐

a) E drejta për mirëqenie dhe kujdes

☐

b) E drejta për të pasur opinion


☐

c) E drejta për të pushuar

☐

d) E drejta për edukim

11.



Cila e drejtë paraqitet në fotografi?

☐

a) E drejta për mirëqenie dhe kujdes

☐

b) E drejta për të pasur opinion


☐

c) E drejta për të pushuar

☐

d) E drejta për të pasur ndjenja

12.



**Cila e drejtë paraqitet
në fotografi?**

☐

a) E drejta për mirëqenie dhe kujdes

☐

b) E drejta për të pasur opinion

☐

c) E drejta për të pushuar

☐

d) E drejta për të pasur ndjenja

13.



**Mbrojtja nga abuzimi dhe
neglizhenca: Nevojë apo dëshirë**

☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

14.



**Ushqim të shëndetshëm:
Nevojë apo dëshirë**


☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

15.



**Udhëtime gjatë pushimeve:
Nevojë apo dëshirë**


☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

16.



**Kompjuter personal:
Nevojë apo dëshirë**


☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

17.



**Mundësi për ta praktikuar
kulturën, gjuhën dhe besimin
fetar: Nevojë apo dëshirë**


☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

18.



**Kënd për lojëra dhe zbavitje:
Nevojë apo dëshirë**

☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

19.



**Rroba të stilit të fundit:
Nevojë apo dëshirë**

☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

20.



Dhomë personale: Nevojë apo dëshirë

☐

a) Nevojë

☐

b) Dëshirë

Përgjigjet

1. c
2. d
3. c
4. b
5. d

6. a
7. d
8. a
9. c
10. a

11. d
12. b
13. a
14. a
15. b

16. b
17. a
18. a
19. b
20. b

Kuiz

Kuizi është interaktiv për të gjithë nxënësit.

Janë tri forma që mund ta zhvilloni kuizin varësisht prej burimeve që keni:

1. Kuizi online. Ju nevojitet kabineti me kompjuterë dhe internet. Varësisht prej hapësirës që keni, mund t'i ndani nxënësit në grupe ose individualisht për mbajtjen e kuizit. Për më shumë informata se si ta përdorni kuizin, shikojeni faqen 108. Klikoni në vjegëzën <https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

Idë shtesë: Mund të kërkonit nga nxënësit të përfundojnë kuizin edhe në shtëpi duke u qasur nëpërmjet vjegëzës së mësipërme dhe duke shkruar emrin e tyre. Pikët e mbledhura për secilin nxënë do t'ju shfaqen automatikisht.

2. Shtypi i kuizit. Kuizi në faqe 111-114 shtypet dhe shpërndahet. Kuizi mund të mbahet individualisht ose në grupe.

3. Shfaqja e pyetjeve në projektor. Shfaqini pyetjet në projektor dhe kërkonit nga nxënësit t'i shkruajnë përgjigjet e sakta në fletore.


Koment: Pas përfundimit të kuizit shkoni me radhë në secilën pyetje dhe komentojini me të gjithë nxënësit në klasë përgjigjet e sakta.

Hapi 1

Klikoni linkun:

<https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

pastaj “START A LIVE QUIZ” dhe pastaj “CLASSIC”.




Pastaj kyçuni duke klikuar “Continue with Google ose Microsoft” varësisht se çfarë e-maili keni, ose shkruani e-mailin me Sign up with email. Është e rëndësishme të regjistroheni në mënyrë që të ruani rezultatet e nxënësve, në të kundërt mund të vazhdoni edhe pa e-mail duke klikuar “Skip for Now”.

Pastaj, nëse dëshironi të mbani kuizin në grupe, përzgjidhni “TEAM” ose nëse dëshironi të mbani kuizin individualisht, përzgjidhni “CLASSIC” dhe në fund klikoni “CONTINUE”.




Do t'ju shfaqet ky kod të cilin duhet t'ua jepni nxënësve. Pasi t'ua jepni kodin, klikoni "START".

4




Pastaj kërkoni nga nxënësit të klikojnë në vjeggzën <https://quizizz.com/admin/quiz/611a6b6f394eb-6001de1b21c> ose në <https://quizizz.com/>. Në anën e djathtë sipër, kërkoni të klikojnë "ENTER CODE" dhe ta shtojnë kodin që iu paraqitet.

5




Ta shtojnë kodin tek "ENTER A JOIN CODE" dhe pastaj të klikojnë "JOIN".

6



Pasi të fillojë kuizi, ju mund të shihni se kush është kyçur dhe nga sa pikë kanë.

6





Të drejtat e fëmijëve

15 Pyetje

Të drejtat e fëmijëve

Klasa 6-9

Emri: _____

Klasa: _____

Data: _____

15 Pyetje

1. Kush është i/e mbrojtur nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës?

- ☐ a) Të gjithë fëmijët e pasur
- ☐ b) Të gjithë fëmijët e varfër nën moshën 10 vjeçare
- ☐ c) Të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeçe
- ☐ d) Të gjithë fëmijët që jetojnë në fshatra

2. Fëmijët që e thyejnë ligjin duhet të:

- ☐ a) Trajtohen sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës
- ☐ b) Të futen në burg me të rritur
- ☐ c) Të futen në burg përgjithmonë
- ☐ d) Të trajtohen mizorisht

3. E drejta për privatësi do të thotë që: (Kjo pyetje mund të ketë më shumë se një përgjigje të saktë).

- ☐ a) Të rriturit nuk duhet të publikojnë fotografi të fëmijëve
- ☐ b) Të rriturit duhet të pyesin para se të publikojnë fotografi të fëmijëve
- ☐ c) Të rriturit duhet të pyesin para se të publikojnë fotografi të fëmijëve
- ☐ d) Rrjetet sociale duhet të ndalohen për fëmijë

4. Si fëmijë kam të drejtë të shpreh mendimin përderisa nuk e dëmtoj dikë tjetër

- ☐ a) E vërtetë
- ☐ b) E pavërtetë

5. Cila nuk është e saktë rreth Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës?

- | | |
|---|--|
| ☐ a) Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë emër | ☐ b) Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë identitet |
| ☐ c) Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të punojnë punë të rënda | ☐ d) Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për privatësi |

6. Pse kanë fëmijët të drejta?

- | | |
|--|--|
| ☐ a) Për të qenë të mbrojtur dhe të respektuar | ☐ b) Për t'ua plotësuar dëshirat |
| ☐ c) Për t'i lejuar të shkojnë ku të dëshirojnë | ☐ d) Sepse fëmijët janë më të vlefshëm se të rriturit |

7. Kush janë përgjegjësit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve? (Kjo pyetje mund të ketë më shumë se një përgjigje të saktë).

- | | |
|---|--------------------------------------|
| ☐ a) Fëmijët | ☐ b) Qeveria |
| ☐ c) Mësimdhënësit | ☐ d) Doktorët |

8. Cila është e saktë?

- | | |
|---|--|
| ☐ a) Disa fëmijë kanë më shumë të drejta se të tjerët | ☐ b) Të gjitha të drejtat janë të ndërlidhura dhe njëjtë të rëndësishme |
| ☐ c) Të drejtat e para në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës janë më të rëndësishme se ato në fund | ☐ d) Asnjë e drejtë e fëmijëve nuk është e rëndësishme |

9. Kur kanë të drejtë fëmijët ta shprehin mendimin e tyre?

(Kjo pyetje mund të ketë më shumë se një përgjigje të saktë).

- | | |
|--|--|
| ☐ a) Kur familja është duke ndërruar vendbanim | ☐ b) Kur shkolla është duke ndërtuar një kënd të lojërave |
| ☐ c) Kur ata ndihen që nuk janë duke u trajtuar në mënyrë të drejtë | ☐ d) Kur të rriturit diskutojnë për politikë |

10. Kush ka nevojë për më shumë ndihmë dhe mbrojtje?

- | | |
|---|---|
| ☐ a) Fëmijët që luajnë në kitarë | ☐ b) Fëmijët që kanë sy të gjelbër |
| ☐ c) Fëmijët nga mosha 5 deri 12 vjeçe | ☐ d) Fëmijët që kanë ikur nga shtëpitë e tyre dhe janë refugjatë |

11. Për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve, ne të gjithë duhet:

- | | |
|--|---|
| ☐ a) Të harrojmë rreth të drejtave tona | ☐ b) Të jemi gjithmonë të lumtur |
| ☐ c) Të mos e shprehim opinionin tonë | ☐ d) Të trajtojmë njëri-tjetrin me respekt |

12. Cila nuk është e drejtë e fëmijëve?

- | | |
|--|--|
| ☐ a) E drejta për të mësuar për të drejtat e fëmijëve | ☐ b) E drejta për t'u mbrojtur nga substanca të dëmshme |
| ☐ c) E drejta për ta shprehur mendimin | ☐ d) E drejta për të bërë çka të dëshirojnë |

13.



Përshkruajeni fotografinë sipas të drejtave për fëmijë. Cili është roli i qeverisë, i shkollës, i shoqërisë dhe i juaji për mbrojtjen e këtyre të drejtave?

14.



Përshkruajeni fotografinë sipas të drejtave për fëmijë kundër diskriminimit. Si mund të ndikojë diskriminimi i fëmijëve në jetën e tyre afatgjatë?

15.



Përshkruajeni fotografinë sipas të drejtave për fëmijë. Cili është roli i qeverisë, i shkollës, i shoqërisë dhe i juaji për mbrojtjen e këtyre të drejtave?

Përgjigjet

1. c
2. a
3. a,b,c
4. a

5. c
6. a
7. b,c,d
8. b

9. a,b,c,d
10. d
11. d
12. d

13. n/a
14. n/a
15. n/a

Kuiz

Kuizi është interaktiv për të gjithë nxënësit.

Janë tri forma që mund ta zhvilloni kuizin varësisht prej burimeve që keni:

1. Kuizi online. Ju nevojitet kabineti me kompjuterë dhe internet. Varësisht prej hapësirës që keni, mund t'i ndani nxënësit në grupe ose individualisht për mbajtjen e kuizit. Për më shumë informata se si ta përdorni kuizin, shikojeni faqen 116. Klikoni në vjegëzën <https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

Idë shtesë: Mund të kërkonti nga nxënësit të përfundojnë kuizin edhe në shtëpi duke u qasur nëpërmjet vjegëzës së mësipërme dhe duke shkruar emrin e tyre. Pikët e mbledhura për secilin nxënë do t'ju shfaqen automatikisht.

2. Shtypi i kuizit. Kuizi në faqe 119-125 shtypet dhe shpërndahet. Kuizi mund të mbahet individualisht ose në grupe.

3. Shfaqja e pyetjeve në projektor. Shfaqini pyetjet në projektor dhe kërkonti nga nxënësit t'i shkruajnë përgjigjet e sakta në fletore.


Koment: Pas përfundimit të kuizit shkoni me radhë në secilën pyetje dhe komentojini me të gjithë nxënësit në klasë përgjigjet e sakta.

Hapi 1

Klikoni linkun:

<https://quizizz.com/admin/quiz/611a2729bde210001db35ac7>

pastaj “START A LIVE QUIZ” dhe pastaj “CLASSIC”.




Pastaj kyçuni duke klikuar “Continue with Google ose Microsoft” varësisht se çfarë e-maili keni, ose shkruani e-mailin me Sign up with email. Është e rëndësishme të regjistroheni në mënyrë që të ruani rezultatet e nxënësve, në të kundërt mund të vazhdoni edhe pa e-mail duke klikuar “Skip for Now”.

Pastaj, nëse dëshironi të mbani kuizin në grupe, përzgjidhni “TEAM” ose nëse dëshironi të mbani kuizin individualisht, përzgjidhni “CLASSIC” dhe në fund klikoni “CONTINUE”.




Do t'ju shfaqet ky kod të cilin duhet t'ua jepni nxënësve. Pasi t'ua jepni kodin, klikoni "START".

4




Pastaj kërkoni nga nxënësit ta klikojnë vjegëzën <https://quizizz.com/admin/quiz/611a8d9f2fcc29001e306c81> ose në <https://quizizz.com/>. Në anën e djathtë sipër, kërkoni që ta klikojnë "ENTER CODE" dhe ta shtojnë kodin që iu paraqitet.

5




Ta shtojnë kodin tek "ENTER A JOIN CODE" dhe pastaj të klikojnë "JOIN".

6



Pasi të fillojë kuizi, ju mund të shihni se kush është kyçur dhe përgjigjet e tyre.

6





Të drejtat e fëmijëve

15 Pyetje

Të drejtat e fëmijëve

Klasa 10-12

Emri: _____

Klasa: _____

Data: _____

15 Pyetje

1.



Përshkruajeni fotografinë, cilat janë simbolet, çfarë paraqet fotografia?

2.



Si ndërlidhet fotografia me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës? Cili nen specifikisht siguron mbrojtjen nga abuzimi? Shih Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

3.



Duke përdorur ligjin dhe nenet përkatëse, krijoni dy deri në tri argumente për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha abuzimet. Shkruani: kush janë përgjegjës sipas ligjit, si të mbrohen këto të drejta, si do të mund të krijoni një shoqëri që mbron fëmijët nga abuzimi?

4.



Përshkruajeni fotografinë, cilat janë simbolet, çfarë paraqet fotografia?

5.



Si ndërlidhet fotografia me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës? Cili nen specifikisht siguron mbrojtjen nga diskriminimi? Shih Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

6.



Duke përdorur ligjin dhe nenet përkatëse, krijoni dy deri në tri argumente për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha llojet e diskriminimit. Shkruani: kush janë përgjegjës sipas ligjit, si të mbrohen këto të drejta, si do të mund të krijoni një shoqëri që mbron fëmijët nga diskriminimi?

7.



Përshkruajeni fotografinë, cilat janë simbolet, çfarë paraqet fotografia?

8.



Si ndërlidhet fotografia me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës? Cili nen specifikisht siguron mbrojtjen nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara? Shih Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

9.



Duke përdorur ligjin dhe nenet përkatëse, krijoni dy deri në tri argumente për mbrojtjen e fëmijëve nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara. Shkruani: kush janë përgjegjës sipas ligjit, si të mbrohen këto të drejta, si do të mund të krijoni një shoqëri që mbron fëmijët nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara?

10.



Përshkruajeni fotografinë, cilat janë simbolet, çfarë paraqet fotografia?

11.



Si ndërlidhet fotografia me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës? Cili nen specifikisht siguron mbrojtjen nga dhuna në internet? Shih Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

12.



Duke përdorur ligjin dhe nenet përkatëse, krijoni dy deri në tri argumente për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në internet. Shkruani: kush janë përgjegjës sipas ligjit, si të mbrohen këto të drejta, si do të mund të krijoni një shoqëri që mbron fëmijët nga dhuna në internet?

13.



Përshkruajeni fotografinë, cilat janë simbolet, çfarë paraqet fotografia?

14.



Si ndërlidhet fotografia me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës? Cili nen specifikisht siguron mbrojtjen nga faqet me përmbajtje pornografike? Shih Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

15.



Duke përdorur ligjin dhe nenet përkatëse, krijoni dy deri në tri argumente për mbrojtjen e fëmijëve nga faqet me përmbajtje pornografike. Shkruani: kush janë përgjegjës sipas ligjit, si të mbrohen këto të drejta, si do të mund të krijoni një shoqëri që mbron fëmijët nga faqet me përmbajtje pornografike?

Përgjigjet e mundshme

PYETJA 1:

Fotografia paraqet forma të ndryshme të abuzimit të fëmijëve: dhunë fizike, dhunë psikologjike, abuzim seksual, keqtrajtim. Neni 47 dhe 48 ndërlidhen me të gjitha llojet e abuzimit ndaj fëmijëve dhe format e mbrojtjes.

Argumentet potenciale: Parandalimi i abuzimit përmes ngritjes së vetëdijesimit të shoqërisë. Krijimi i mekanizmave mbrojtës për fëmijë të abuzuar.

PYETJA 2:

Fotografia paraqet diskriminimin e fëmijëve në bazë të racës, gjinisë dhe etnisë. Gjithashtu, grilat janë simbolikë e mbylljes së vajzës rromë nga shoqëria dhe pamundësia për të pasur qasje në mundësitë e ofruara.

Neni 8 paraqet mbrojtjen e fëmijës nga diskriminimi.

Argumentet potenciale: Krijimi i mekanizmave që u ofrojnë më shumë mundësi dhe qasje në shoqëri minoriteteve. Dënimi i të gjitha formave të diskriminimit.

PYETJA 3:

Fotografia paraqet rrezikun nga përdorimi dhe blerja e lëndëve narkotike nga fëmijët. Shihet qartë që të rriturit janë furnizuesit kryesorë që u afrohen fëmijëve për shitjen e lëndëve narkotike.

Neni 43 paraqet mbrojtjen e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara. Argumentet potenciale: Vendosja e stacionit policor afër shkollave për parandalimin e

qasjes së shitësve të narkotikëve. Ngritja e vetëdijesimit të fëmijëve rreth rreziqeve të përdorimit të lëndëve narkotike.

PYETJA 4:

Fotografia paraqet abuzimet e ndryshme që ndodhin online. Fokusi është te dhuna përmes internetit (kryesisht psikologjike). Neni 47 dhe 48 ndërlidhen me të gjitha llojet e abuzimit ndaj fëmijëve dhe format e mbrojtjes.

Argumentet potenciale: Parandalimi i dhunës në internet përmes ngritjes së vetëdijesimit të fëmijëve rreth efekteve nga dhuna në internet. Krijimi i mekanizmave brenda shkollës dhe komunës për parandalimin dhe dënimin e dhunës në internet.

PYETJA 5:

Fotografia paraqet qasjen e lehtë të fëmijëve në përmbajtje të papërshtatshme në internet (dhunë, pornografi, lojëra bixhozi).

Neni 52 është kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës.

Argumentet potenciale: Fuqizimi i mekanizmave shtetërorë për kontrollimin e faqeve të internetit me përmbajtje të papërshtatshme. Ngritja e vetëdijesimit të prindërve rreth mekanizmave për kufizimin e përdorimit të disa faqeve të internetit nga fëmijët.

Autore e doracakut:

Gresa Statovci

Titulli:

Doracak për mësimdhënës me aktivitete mbi të drejtat e fëmijëve

Botuar nga:

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)

Projekti:

PROtectChild

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Urdhë Përmirësues - Office of the Prime Minister
Zyra për Qendrueshëm të Mirë-Komandëja në Detyrë Uspërkëje/Office on Good Governance



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministaro Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



Save the Children



Sweden
Sverige